

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**



**FAKULTETI JURIDIK**  
**ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ**  
**FACULTY OF LAW**

**STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË**

**T E Z A:**

**VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE NË REPUBLIKËN E**  
**MAQEDONISË NË PERIUHDHËN KOHORE 2009-2014**

**KANDIDATI:**  
**Merita MEMEDOVA**

**MENTORI:**  
**Prof. Dr. sc. Jeton SHASIVARI**

**Tetovë, Mars, 2020**

## **Mirënjohje**

Mirënjohje dhe falenderime për udhëheqësin shkencor Prof.Dr.sc. Jeton Shasivarin, për mbështetjen profesionale dhe akademike që më ka dhënë gjatë gjithë procesit të punimit të tezës së magjistraturës, për përkushtimin, këshillat dhe nxitjen në realizimin sa më të mirë të këtij punimi.

Mirënjohje e veçantë dhe falenderime për familjen e dashur veçanërisht nënën time, mbështetja dhe motivimi i së cilës kanë qenë nxitja ime më e madhe.

## PËRMBAJTJA

Hyrje

### KAPITULLI I PARË

1.1 Nocioni, llojet dhe karakteristikat e veprave penale kundër detyrës zyrtare .....	9
1.2 Llojet e veprave penale kundër detyrës zyrtare .....	12
1.2.1 Karakteristikat e veprave penale kundër detyrës zyrtare .....	13
1.3. Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar .....	15
1.4 Shkelja e ruajtjes së kufirit shtetëror .....	16
1.5 Moszbatimi i urdhërit .....	16
1.6 Puna e pandërgjegjshme gjatë detyrës.....	18
1.7 Evidencat statistikore në organet e ndjekjes për veprat penale Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar për vitet 2009-2014 .....	19
1.8 Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e këtyre veprave penale .....	21
1.9 Raporti mes kryerësit dhe veprës penale .....	21
1.10 Shkaqet të cilat ndikojnë në kryerjen e këtyre veprave penale .....	22
1.11 Profili i kryerësve të veprave penale .....	24
1.11.1 Moshë, gjinia dhe përkatësia etnike e kryerësve të veprave penale .....	24
1.11.2 Shkalla e arsimimit të kryerësve të veprave penale .....	25
1.11.3 Organet në të cilat kryhen veprat penale keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar.....	26
1.12 Sanksionet me të cilat janë denuar kryerësit e veprave penale përvitet 2009-2014 .....	27

### KAPITULLI I DYTË

2.1 Nocioni i veprës penale keqpërdorimi i shërbimit.....	33
2.2 Mashtrimi gjatë shërbimit .....	35
2.3 Të shërbyerit gjatë detyrës .....	35
2.4 Evidencat statistikore në organet e ndjekjes për veprat penale keqpërdorimi i shërbimit për vitet 2009-2014 .....	35
2.5 Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e këtyre veprave penale .....	36
2.6 Raporti mes kryerësit dhe veprës penale .....	37
2.7 Shkaqet të cilat ndikojnë në keqpërdorimin e shërbimit .....	38
2.8 Profili i kryerësve të veprave penale keqpërdorimi shërbimit .....	38
2.8.1 Moshë, gjinia dhe përkatësia etnike e kryerësve të veprave penale .....	38
2.8.2 Shkalla e arsimimit të kryerësve të veprave penale .....	39

2.9 Organet në të cilat kryhen vepra penale keqpërdorimi i shërbimit .....	39
2.10 Sanksionet të cilat janë denuar kryerësit e veprave penale përvitet 2009-2014 .....	39

### **KAPITULLI I TRETË**

3.1 Nocioni i veprës penale marrja dhe dhënia e ryshfetit.....	43
3.2 Marrja e ryshfetit .....	43
3.3 Dhënia e ryshfetit.....	44
3.4 Ndërmjetësimi i kundërligjshëm.....	45
3.5 Fitimi i kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur.....	46
3.6 Zbulimi i fshehtësisë zyrtare .....	48
3.7 Keqpërdorimi i fshehtësisë shtetërore, zyrtare apo ushtarake .....	49
3.8 Evidencat statistikore në organet e ndjekjes për veprat penale marrja dhe dhënia e ryshfetit .....	50
3.9 Të raportuar dhe të ndjekur penalisht për veprën penale marrja e ryshfetit .....	50
3.9.1 Të raportuar dhe të ndjekur penalisht për veprën penale dhënia e ryshfetit.....	51
3.10 Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale të ryshfetit.....	51
3.11 Raporti mes personit zyrtar dhe personit që jep ryshfet.....	52
3.12 Shkaqet dhe arsyet pse bëhet ryshfeti .....	52
3.13 Profili i kryerësve të veprave penale marrja dhe dhënia e ryshfetit .....	55
3.13.1 Moshë, gjinia dhe përkatësia etnike .....	55
3.13.2 Shkalla e arsimimit të kryerësve.....	55
3.14 Organet në të cilat kryhet ryshfeti.....	56
3.15 Sanksionet të cilat janë denuar kryerësit e veprave penale marrja dhe dhënia e ryshfetit për vitet 2009-2014 .....	56

### **KAPITULLI I KATËRT**

4.1 Nocioni i veprës penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare.....	65
4.2 Arkëtimi dhe pagesa kundërligjore.....	69
4.3 Evidencat statistikore në organet e ndjekjes për veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare për vitet 2009-2014.....	70
4.4 Të raportuar dhe të ndjekur penalisht për veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare .....	70
4.5 Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale .....	71
4.6 Raporti mes kryerësit dhe veprës penale .....	71
4.7 Arsyet për falsifikimin e dokumenteve zyrtare.....	72
4.8 Profili i kryerësve të veprës penale falsifikimi i dokumenteve .....	73

4.8.1 Moshë, gjinia dhe përkatësia etnike e kryerësve .....	73
4.8.2 Shkalla e arsimimit .....	74
4.9 Organet në të cilat kryhet falsifikimi i dokumenteve dhe arkëtimi kundërligjor .....	74
4.10 Sanksionet të cilat janë denuar kryerësit e veprës penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare prej vitit 2009 deri me 2014 .....	77
PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....	79
BIBLIOGRAFIA.....	81

## HYRJE

Kryesisht në temën e sipërshenuar do t'i jepet rëndësi elaborimit/definimit të veprave penale kundër detyrës zyrtare si: keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar, keqpërdorimi i shërbimit, përfitimi në mënyre të paligjshme, marrja dhe dhënia e ryshfetit, menytrat e pagesës, korrupsioni, faktoret/arsyet pse bëhet marrja/dhënia e ryshfetit, mashtrimi në detyrë, falsifikimi i dokumenteve zyrtare, si dhe shumë vepra tjera të këtij kapitulli. Kështu, duke përcaktuar edhe veprimet e përbashkëta të këtyre veprave penale, si çka nënkuptohet me detyrë zyrtare, kush mund të jetë person zyrtar, dashja si dhe qëllimi si element i veçantë konstituiv i këtyre veprave penale.

Poashtu, lëndë hulumtimi do të jenë veprat penale kundër detyrës zyrtare të evidentuara në aktivitetet e organeve të ndjekjes penale, karakteristikat fenomenologjike të rasteve të veprave penale kundër detyrës zyrtare, përcaktimi i profilit të kryerësve të veprave penale kundër detyrës zyrtare, organet shtetërore në të cilat kryhen/ janë kryer veprat penale, dënueshmëria e këtyre veprave si dhe evidencat statistikore në lidhje me këto vepra penale.

Lëndë hulumtimi për këtë punim janë edhe: aktet normative si: kodi penal i RM-së, ligji për korrupsion; ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, literatura shkencore e autorëve të librave të ndryshme që i përgjigjen kësaj teme; evidencat statistikore nga organet për ndjekje penale, evidencat statistikore nga Enti i statistikave dhe burimet nga interneti.

Struktura e punimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet plotësisht qëllimit të përzgjedhjes së kësaj teme, duke nxjerrë në pah elementët më tipikë që lidhen sot me fenomenin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave në rradhë të administratës publike dhe funksionarëve të lartë publik.

Tema në fjalë ka një interaksion edhe me të drejtën administrative, konkretisht me kontrollin gjyqësor të tërthortë (të përgjithshëm) mbi administratën, kontroll ky, i cili sipas Prof. Shasivari, realizohet nga gjykatat lidhur me çështjet penale, civile e të tjera, që parasëgjithash rregullohen me ligjet përkatëse. Në çështjet penale, gjykatat e realizojnë kontrollin gjyqësor të tërthortë mbi administratën në çështjet penale sipas dispozitave të Kodit penal dhe të Ligjit për

procedurë penale. Në kuadër të kësaj, këto gjykata, mes tjerash, vendosin për ekzistimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare, si për shembull: keqpërdorimi i pozitës dhe detyrës zyrtare, pranimi dhe dhënia e ryshfetit, etj. Në çështjet civile, gjykatat e realizojnë kontrollin gjyqësor të tërthortë mbi administratën në çështjet civile sipas dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore dhe të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore. Në kuadër të kësaj, këto gjykata, mes tjerash, vendosin për marrëdhëniet detyrimore që krijohen midis administratës dhe personave të tjerë, si dhe për dëmin që mund të paraqitet me këtë rast, si për shembull: mospërmbushja e kontratës për rinovimin e ndërtesës administrative<sup>1</sup>.

### **Qëllimet e hulumtimit**

Objektivi kryesor i këtij punimi të MA është të përcaktohen konceptet dhe veprat kundër detyrës zyrtare të ngushta me karakteristikat e tyre, format e tyre të pranishme, të përcaktuara në kodin tonë penal, karakteristikat e veprave penale kundër detyrës zyrtare, personat (zyrtar) të cilët janë autoret e këtyre veprave penale dhe gjithë kjo për të kuptuar në mënyrë pragmatike rëndësinë e këtyre veprave penale.

Si objekt i drejtpërdrejtë i këtij studimi është përcaktuar një kategori dispozitash penale, që kanë subjekt të posaçëm punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, të cilët gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, të ndikuar nga interesat private, mund të veprojnë në kundërshtim me ligjin, duke shkaktuar pasoja për individët, shoqëritë tregtare apo shtetin.

Nisur nga rëndësia e realizimit të një studimi shkencor në një fushë kaq të prekshme dhe aktuale si korrupsioni, janë trajtuar gjërësisht veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, të lidhura këto me konfliktin e interesave, si një element që shoqëron, pason ose paraprin veprimet kriminale të kryera nga funksionarët publikë, duke qenë se në tërësi në këtyre veprave penale mbizotëron elementi i përfitimit personal, për shkak të funksionit të veçantë.

Qëllim kryesor në këtë hulumtim poashtu është edhe studimi i rasteve nga praktika gjyqësore për veprat penale kundër detyrës zyrtare veç e veç duke nxjerr në pah rastet e evidentuara në prokurorinë publike, të dhëna statistikore për kryerësit e v.p., organet në të cilat punojnë kryerësit, organet në të cilat më së shpeshti kryhen veprat penale kundër detyrës zyrtare,

---

<sup>1</sup> Për më tepër shih në: Shasivari, Dr., Jeton, E drejta administrative, Shkup, 2015, fq. 126-127.

profilin e kryeresve të veprave penale kunder detyrës zyrtare dhe sanksionet të cilat u janë shqiptuar kryerësve.

Teza themelore që përshkron këtë punim shkencor është fakti që korrupsioni nuk mund të ekzistojë pa një konflikt interesi dhe se, nëse një institucion shtetëror është në gjendje të menaxhojë në mënyrë efektive konfliktet e interesit, rrjedhimisht do jetë në gjendje të menaxhojë përballjen e tij me korrupsionin.

### **Metodologjia e hulumtimit**

Metodologjia e hulumtimit të këtij punimi do të ngërthejë: metodën dogmatike e cila merret me vërtetimin e domethënieve konkrete të normës juridike me ç'rast caktohet sjellja, të cilën e drejta u urdhëron njerëzve; metoda normative me anën e së cilës hulumtohet ana formale e normave dhe e akteve juridike.

Një ndër metodat më të rëndësishme në metodologjinë e këtij hulumtimi është metoda e studimit të rasteve me ç'rast analizohen veprat penale në gjykatat kompetente të vendit për veprat penale të kryera kundër detyrës zyrtare, të dhënat lidhur me vendin e punës, profesionin, moshën, gjininë, kushtet si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale.

Metoda tjera me rëndësi janë metodat statistikore si metoda mjaft të përshtatshme për mbledhjen, përcjelljen dhe pasqyrimin e të dhënave të ndryshme lidhur me vëllimin, dinamikën, strukturën dhe karakteristikat e tjera të veprave penale kundër detyrës zyrtare të kryera në Republikën e Maqedonisë; metoda e ligjit të numrave të mëdhenj me të cilën arrihen rezultate objektive duke përfshirë sa më shumë dukuri dhe raste të veprave të këtilla; metoda e korrelacionit, mesatares dhe përqindjes, me anën e të cilave pasqyrohet raporti në mes të veprave penale dhe moshës/gjinisë, shkallës së arsimimit, paraqitjet tabelore dhe indeksat që kanë të bëjnë me dukurinë e veprave penale kundër detyrës zyrtare.

Punimi ka arritur të japë një tablo të plotë të çështjeve kryesore që lidhen me konfliktin e interesave dhe korrupsionin në sajë të përshkrimit të disa prej faktorëve kryesorë që lidhen me fenomenin e korrupsionit apo abuzimit me funksionin publik dhe formave të ndikimit të interesave private gjatë ushtrimit të funksioneve publike.



## **Rëndësia e punimit**

Veprat kundër detyrës zyrtare gjithmonë në të gjitha sistemet juridike kanë shkaktuar shqetësim të veçantë për shkak të objektit të mbrojtjes dhe statusin e kryeresve të saj, ku objekti kryesor i mbrojtjes është trajtimi i ligjshëm, i ndërgjegjshëm dhe i duhur i zyrtarëve në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.

Rëndësia e këtij punimi qëndron në atë se në kohën bashkëkohore veprat penale kundër detyrës zyrtare janë reflektim i dobësive dhe të meta të shtetit, përkatsisht segmentin e tij funksional të shprehur nga zyrtarët me çka keqpërdorimi i pushtetit është në përpjesëtim me funksionimin e shtetit ligjor. Si rezultat i kësaj shërbejnë të dhënat statistikore për periudhën nga viti 2009-2014, ku numri i te akuzuarve për këto lloj veprash është në rritje.

Numri më i madh i raportuar janë për v.p. keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar, falsifikim i dokumenteve zyrtare dhe marrjes së rryshfetit.

Rëndësi tjetër e punimit është edhe praktika gjyqësore me rastet konkrete lidhur me veprat penale kundër detyrës zyrtare e cila ngre pyetje për profesionalizëm më të madh dhe dije profesionale për të luftuar këtë lloj të kriminalitetit.

Vlen të theksohet edhe dukuria e korrupsionit si përkeqësim i vlerave morale të shoqërisë, një formë e sulmit ndaj detyrave zyrtare, ku vetë-interesi është vendosur mbi interesat e një komuniteti politik. Andaj duhet të ndërmerren masa për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së tij, si dhe punë më efektive të komisioneve për antikorrupsion.

Punimi do të nxjerrë rezultatet, përfundimet dhe rekomandimet e duhura, të cilat kanë të bëjnë me atë se duhet të ndërmerren mjete dhe mekanizma të duhura me anën e të cilave të rritet operativiteti i zyrtarëve, arrijen e disiplinës së zyrtarëve dhe ngritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me këto lloje të veprimeve të kundërligjshme. Andaj sistemi i kontrollit dhe zbulimit për këto lloje të veprimeve të paligjshme është thelbësor si një aktivitet i rregullt në luftimin e këtyre veprave penale.

## KAPITULLI I PARË

### 1.1 NOCIONI, LLOJET DHE KARAKTERISTIKAT E VEPRAVE PENALE KUNDER DETYRES ZYRTARE

Në mënyrë që të mundësohet sundimi i ligjit dhe kufizimi i pushtetit shtetëror, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë ka parashikuar krimet kundër detyrës zyrtare. Krimet kundër detyrës zyrtare, janë quajtur krime të nëpunësve zyrtar, që përfaqësojnë një grup të veprave penale që kanë vend të veçantë në të drejtën penale. Zakonisht këto janë vepra të keqpërdorimit të pushtetit, pozitës apo autoritetit zyrtar, përdorimi i pozitës zyrtare për aktivitete të papranueshme në kundërshtim me natyrën ligjore të shërbimit publik.

Teoria penale has në mendim të pandarë në lidhje me atë se çka e përbën veprën penale kunder detyrës zyrtare, të cilat janë katër elemente tipike:

- kryeres i këtyre krimeve është personi zyrtar (ose përgjegjës në qoftë se është e paraparë me ligj);
- me kryerjen e këtyre krimeve shkelet detyra zyrtare;
- këto vepra penale mund të behen vetëm në kryerjen e detyrës zyrtare, dhe
- si element baze që vlen për të gjitha veprat penale, keto vepra të jenë të parapara me ligj si vepra penale.

Bazuar në këto elemente, vepra penale kundër detyrës zyrtare mund të përkufizohet si shkelje e detyrës zyrtare e cila kryhet nga personi zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare për të cilën është kompetent.<sup>2</sup>

Me vet nocionin detyrë zyrtare nënkuptohet një lidhje nënshtrimi, që do të thotë detyrë ndaj dikujt.<sup>3</sup>

Pushteti shtetëror në rrënjët e tij shoqërore është i kufizuar, ndërsa nga fuqia e tij i pakufizuar. Për këto arsye, është e nevojshme për të kufizuar pushtetin e bartësve të funksionareve të pushtetit. Ata duhet të vendosen në korniza të forta në mënyrë që të realizohet sundimi i ligjit dhe për të parandaluar dualizmin e pushtetit, të shprehur përmes ndarjes të aparatit të veçantë burokratik – në shtresën administrative, nga bartësit e pushtetit.

---

<sup>2</sup>J. Tahovikj, E Drejta Penale, Pjesa e veçantë, Beograd 1953, fq. 452.

<sup>3</sup>V.Kambovski, E Drejta Penale, Pjesa e vecante, Shkup 2003, fq. 495.

Si persona zyrtarë sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë, kur ky është caktuar si kryerës i veprës penale llogaritet:

- a) kryetari i Republikës së Maqedonisë, ambasadorët dhe përfaqësuesit tjerë të vënë të Republikës së Maqedonisë në botën e jashtme dhe persona të emëruar nga kryetari i Republikës së Maqedonisë, funksionar i zgjedhur ose i emëruar në dhe nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në organet e administratës shtetërore, në gjykatat, prokurorinë publike, Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, Këshillin e prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë dhe organe dhe organizata tjerë që kryejnë punë tjerë në Kornizat e të drejtave dhe detyrimeve të Republikës, në njësitë e vetadministrimit lokal, si dhe persona që në mënyrë permanente apo të perkohshme kryejnë detyra zyrtare në këto organe dhe organizata;
- b) nëpunësi shtetëror që kryen punë profesionale, normativo-juridike, ekzekutive, administrativo-mbikqyrëse dhe punë administrative në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;
- c) personi i autorizuar në personin juridik të cilit me ligj ose me dispozitë tjerë të marrë në bazë të ligjit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, kur detyrën e ushtron në suaza të këtyre autorizimeve;
- d) personi i cili ushtron detyra të caktuara zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj apo me dispozita të tjera të miratuara në bazë të ligjit;
- e) personi ushtarak kur janë në pyetje veprat penale të cilat si kryerës është caktuar personi zyrtar dhe
- f) përfaqësuesi i shtetit të huaj ose i organizatës ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë.
- g) Si person i huaj zyrtar, kur ai është caktuar si kryerës i veprës penale, llogaritet personi i cili në shtetin e huaj, organizatën ndërkombëtare apo institucionin publik ushtron ndonjë nga funksionet apo detyrat e caktuara në paragrafin 4 pikat a deri në d nga ky nen.

h) Me person juridik nënkuptohet: Republika e Maqedonisë, njësitë e vetqeverisjes vendore, partitë politike, ndërmarrjet publike, shoqatat tregtare, institucionet dhe asociacionet e tjera, fondet, organizatat financiare dhe organizatat e tjera të caktuara me ligj të regjistruar si persona juridik dhe bashkësitë dhe organizatat e tjera të cilave u njihet cilësia e personave juridik. Si person i huaj juridik nënkuptohet ndërmarrja publike, institucioni, fondi, banka, shoqata tregtare ose forma tjera të organizimit sipas ligjit të shtetit të huaj për të kryer veprimtari ekonomike, financiare, bankare, tregtare, shërbyese apo veprimtari tjera, që ka seli apo është e themeluar si shoqatë, fond, bankë apo institucion ndërkombëtar.

Ndërsa si i) person përgjegjës në personin juridik llogaritet personi i cili duke pasur parasysh funksionin e tij ose në bazë të autorizimeve të veçanta në personin juridik i është besuar një qark i caktuar të punës që i përkasin zbatimit të dispozitave ligjore apo të dispozitave të miratuara në bazë të ligjit apo të aktit të përgjithshëm të personit juridik në administrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e pasurisë, udhëheqjen me procesin prodhues dhe afarist ose me ndonjë proces tjetër ekonomik apo mbikqyrjen e tyre. Si person përgjegjës llogaritet edhe personi zyrtar kur janë në pyetje veprat të cilat si kryerës është caktuar personi përgjegjës, por nuk janë të parapara në kreun e veprave penale kundër detyrës zyrtare, përkatësisht si vepra penale të personit zyrtar të parapara në ndonjë kapitull tjetër të Kodit Penal të RM-së. Kur ajo është e paraparë në veçanti me këtë kod, si person përgjegjës llogaritet edhe personi i cili ushtron funksion apo autorizim të veçantë apo të cilit i është besuar ushtrim i mëvetësishëm të punëve të caktuara në personin e huaj juridik, si dhe personi i cili është përfaqësues i personit të huaj juridik në Republikën e Maqedonisë.

k) kur si kryerës i veprës penale është caktuar personi zyrtar ose përgjegjës, të gjithë personat e cekur në paragrafet 4, 5 dhe 7 mund të jenë kryerës të atyre veprave nëse nga tiparet ligjore të veprës së caktuar nuk del se kryerës mund të jetë vetëm ndonjëri nga ata persona.<sup>4</sup>

Ndërsa sipas ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konflikt të interesave me nocionin "person zyrtar" nënkuptohen të gjithë personat e zgjedhur ose emëruar dhe të punësuarit në

---

<sup>4</sup>Neni 122, paragrafi 4-8, fq.119-121, KPM.

sektorin publik.<sup>5</sup> Ndërsa me “detyrë zyrtare” nënkuptohet shuma e obligimeve të cilat një person detyrohet t’i ndërmarrë, e të cilat dalin nga kryerja e funksionit ose profesionit të caktuar, përkatësisht nga pozita zyrtare e atij personi.<sup>6</sup>

## **1.2 LLOJET E VEPRAVE PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE**

Llojet e veprave penale kundër detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë janë të përcaktuara në kreun XXX dhe janë të klasifikuara si më poshtë:

1. Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar (Neni 353),
2. Shkelja e ruajtjes së kufirit shtetëror (Neni 353-a),
3. Moszbatimi i urdhërit (Neni 353-b),
4. Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës (Neni 353-c),
5. Shpërdorimi i shërbimit (Neni 354),
6. Mashtrimi gjatë shërbimit (Neni 355),
7. Të shërbyerit gjatë detyrës (Neni 356),
8. Marrja e ryshfetit (Neni 357),
9. Dhënia e ryshfetit (Neni 358),
10. Ndërmjetësimi i kundërligjshëm (Neni 359),
11. Fitimi i kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur (Neni 359-a),
12. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (Neni 360),
13. Keqpërdorimi i fshehtësisë shtetërore, zyrtare apo ushtarake (Neni 360-a),
14. Falsifikimi i dokumentëve zyrtare (Neni 361),
15. Arkëtimi dhe pagesa kundërligjore (Neni 362).

---

<sup>5</sup> Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RM-së janar 2019, nr. 12, faqe 26, neni 8, paragrafi 2

<sup>6</sup> Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RM-së janar 2019, nr. 12, faqe 26, neni 8, paragrafi 10

### 1.2.1 KARAKTERISTIKAT E VEPRAVE PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE

Veprat penale kundër detyrës zyrtare paraqesin sjellje të paligjshme të drejtuara kundër funksionimit të duhur të shërbimeve publike që i kryejnë personat zyrtarë në ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare ose në lidhje me ushtrimin e tyre. Ky lloj i veprave penale sot bie në kategorinë e krimeve me një shkallë jashtëzakonisht të lartë të rrezikut për shoqërinë. Kjo pasqyrohet jo vetëm në pasojat materiale të kryera nga këto vepra, por sidomos në shkatërrimin dhe prishjen e tendencave kryesore të jetës shoqërore nëpërmjet sulmit mbi vlerat morale të shoqërisë.<sup>7</sup>

Krimet kundër detyrës zyrtare në të gjitha sistemet ligjore kanë shkaktuar interesim të madh për shkak të objektit të mbrojtjes dhe statusit të kryerësve të tyre.

Objekti kryesor i mbrojtjes së veprave penale kundër detyrës zyrtare është veprimi i ligjshëm, i ndërgjegjshëm dhe i duhur i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.

Këto lloje të krimeve karakterizohen me atë që kryhen në zbatimin e detyrës zyrtare nga ana e personave zyrtarë që duke i keqpërdorur autorizimet e tyre publike dhe zyrtare, kryejnë vepra penale që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të tyre, ose duke shfrytëzuar pozitën e tyre, për të ndërmarrë veprime të cilat janë përtej kompetencave të tyre.

Krimet kundër detyrës zyrtare paraqesin një formë të sulmit kundër interesave shtetërore për integritetin e kompetencave të nëpunësve civilë dhe mbrojtjen e besimit në përmbushjen jo të rregullt të detyrave zyrtare.

Si vepër penale kundër detyrës zyrtare nuk konsiderohet vepra penale e kryer nga ata zyrtarë të njejtë jashtë ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre. Me kryerjen e këtyre veprave penale personat zyrtarë e keqpërdorin pushtetin dhe autorizimet e tyre të cilat shteti ua ka besuar për të kryer detyrën e tyre.

Karakteristikë kryesore e këtyre krimeve është pikërisht statusi i personave të cilët mund të kryejnë këto vepra, domethënë si kryerësit e këtyre krimeve mund të jenë vetëm personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

---

<sup>7</sup> Grupa autora, Komentari krivičnih/kaznenih zakona u Bosni i Hercegovini, Knjiga I, Vijeće Evrope i Europska Komisija, Sarajevo, 2005., str. 706.

Në ekzekutimin e këtyre krimeve, si një formë e fajësisë, kryerësi vepron me paramendim, prandaj, zyrtarët gjithmonë veprojnë me qëllim, dhe zakonisht kanë qëllim të drejtpërdrejtë (dolus directus).

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, funksionit menaxhues ose administrativ konsiderohet se ekziston kur personi e kryen veprën penale duke e ushtruar njëren nga këto veprimtari. Pikërisht kur kryerësi me vetëdije e ka shfrytëzuar ushtrimin e këtyre veprimtarive me qëllim që të kryejë vepër penale.<sup>8</sup>

Ajo që është e përbashkët në të gjitha veprat penale kundër detyrës zyrtare, është shprehja përfitim i parregullt, që përfshin përfitime materiale dhe përfitime jomateriale (premtim punësimi në të ardhmen, privilegje, trajtime preferenciale, etj.), me çka rezulton në një gjendje ose në konflikt interesi të zyrtarit.

Duke qenë se të gjithë zyrtarët publik kanë interesa legjitime edhe nga të qenit qytetarë të thjeshtë, konfliktet e interesave nuk duhet të shmangen, por duhet përkufizuar, identifikuar dhe trajtuar në kohën e duhur.

Në këtë proces, shtetit i lind detyrimi që me instrumentët ligjorë t'i parandalojë këto situata dhe të sigurojë që personat zyrtar të mos ndikohen në vendimmarrjen e tyre nga interesat private. Në R.M., në legjislacionin e brendshëm janë parashikuar kufizime dhe ndalime të posaçme të interesave private, rregulla dhe procedura për identifikimin e konfliktit të interesave me qëllim parandalimin e tij.

Ligji aktual që rregullon çështjet e konfliktit të interesave, jep këtë përkufizim: Konflikt interesash nënkupton gjendjen kur interesi privat bie ndesh me interesin publik ose kur interesi privat ndikon ose mund të ndikojë në paanshmerinë e tij gjatë kryerjes së punëve me interes publik.

Qëllimi i Ligjit për parandalimin e konflikteve të interesit është që të rregullohen masat dhe aktivitetet për parandalim të korrupsionit në ushtrimin e pushtetit, autorizimeve publike, detyrës zyrtare dhe politikës, masat dhe aktivitetet për parandalim të korrupsionit gjatë

---

<sup>8</sup> I. Salihu, E Drejta Penale, Prishtine, 2005, fq.493.

kryerjes së punëve me interes publik të personave juridikë në lidhje me realizimin e autorizimeve publike.<sup>9</sup>

### 1.3 KEQPËRDORIMI I POZITËS DHE AUTORIZIMIT ZYRTAR

Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar përfshin veprimet e paligjshme të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me qëllim përfitimi për vete ose për dikë tjetër, ose t'i shkaktojë dëm dikujt tjetër. Kjo vepër ndryshon nga veprat e tjera zyrtare, të tilla si disiplinore. Me nocionin "autorizim publik" nënkuptohet autorizimi, i bartur nga ana e pushtetit shtetëror ose lokal, personit fizik ose juridik që të kryejë punë me interes publik.<sup>10</sup>

Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar ka karakter të përgjithshëm penal si krim kundër detyrës zyrtare, duke pasur parasysh se shumica e veprave të tjera kundër detyrës zyrtare janë forma të veçanta të këtij krimi, por që ka të bëjë në lidhje me karakterin e tyre plotësues, d.m.th. vlen vetëm në qoftë se veprimtaria e personit zyrtar apo përgjegjës nuk mund të cilësohet si një nga ato vepra.<sup>11</sup>

KPM me keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar nënkupton:

- (1) Personi zyrtar i cili me shfrytëzimin e pozitës apo të autorizimit të vet zyrtar, me tejkalimin e kufijve të autorizimit të vet zyrtar apo me moszbatimin e detyrës së vet zyrtare do të përfitojë për vete ose për tjetërkend ndonjë dobi ose tjetërkujt do t'i bëjë dëm, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.
- (2) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 do të përfitojë dobi më të madhe të pasurisë apo do të shkaktojë dëm më të madh të pasurisë apo më rëndë do t'i shkelë të drejtat tjetërkujt, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- (3) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 përfiton dobi të konsiderueshme të pasurisë apo shkakton dëm të konsiderueshëm, kryerësi do të dënohet me së paku tre vjet burgim.
- (4) Me denimin nga paragrafet 1, 2 dhe 3 do të dënohet edhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik që ka përfaqësi apo kryen veprimtari në Republikën e Maqedonisë apo personi që kryen punë me karakter publik, nëse vepra është kryer gjatë kryerjes së autorizimit apo detyrës së tij të posaçme.

---

<sup>9</sup> Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RM-se janar 2019, nr. 12, faqe 26, neni 3, paragrafi 1

<sup>10</sup> Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RM-se janar 2019, nr. 12, faqe 26, neni 8, paragrafi 9

<sup>11</sup> Babid, Miloš, Markovic Ivanka, Krivično pravo, posebni dio, Banja Luka, 2007., str. 248.



(5) Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 4 është kryer gjatë kryerjes së furnizimeve publike apo në dëm të mjeteve nga Buxheti I Republikës së Maqedonisë, nga fondet publike apo nga mjetet tjera të shtetit, kryerësi do të denohet me së paku pesë vjet burgim.<sup>12</sup>

#### **1.4 SHKELJA E RUAJTJES SE KUFIRIT SHTETËTOR**

Ligjit për Kontrollim kufitar, "Kufirin shtetëror" e definon si: kufiri tokësor i Republikës së Maqedonisë, përfshirë kufirin e lumenjve dhe liqeneve, si dhe aeroportet dhe portet liqenore të përcaktuara si vende për trafik ndershtetëror dhe ndërkombëtar.<sup>13</sup>

Sipas Kodit penal te Republikës se Maqedonise, neni 353 a, shkelje te ruajtjes se kufirit shtetëror e kryen:

- (1)Personi zyrtar i cili duke e kryer shërbimin në kufi do të veprojë kundër rregullave për ruajtjen e kufirit shtetëror, dhe për këtë do të shkaktohen pasoja më të rënda dëmtuese për shërbimin, shërbimi është më rëndë i rrezikuar, do të denohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.
- (2)Nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 është shkaktuar lëndim më të rëndë trupor apo dëm të pasurisë të mëdha, apo janë shkatëruar pasoja tjera të rënda, kryerësi do të denohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- (3)Nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 është shkaktuar vdekje e ndonjë personi, kryerësi do të denohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (4)Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të denohet me gjobë apo me burgim deri në një vjet.
- (5)Nëse për shkak të veprës nga paragrafi 4 është shkaktuar pasoja nga paragrafi 2, kryerësi do të denohet me gjobë apo me burgim deri në tre vjet, kurse, nëse është shkaktuar pasoja nga paragrafi 3, kryerësi do të denohet me burgim prej një deri në pesë vjet.<sup>14</sup>

#### **1.5 MOSZBATIMI I URDHERIT**

Urdhëri - jepet me qëllim të zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve të tjera. Për shembull, ekzekutimi i urdhërave në Armatën e RM-së është baza për zhvillimin e suksesshëm të punës së ushtrisë dhe kryerjen e obligimeve dhe detyrave.

---

<sup>12</sup>Neni 352, paragrafi 1-5, fq.280-281, KPM.

<sup>13</sup> Закон за гранична контрола, Службен весник бр.148/15, член 3, став 2

<sup>14</sup>Neni 353-a, paragrafi 1-5, fq.281, KPM.

Personeli i shërbimit ushtarak dhe civil në Armatë, në ushtrimin e detyrave të tyre janë të detyruar: - të kryejnë urdhërin e dhënë nga eprori i tyre për kryerjen e shërbimit me ndërgjegje, pa kundërshtim dhe në kohën e duhur.

Urdhri jepet gojarisht ose me shkrim. Një zyrtar kryesues që ka dhënë një urdhër për të ndërmarrë një veprimtari me kryerjen e së cilës mund të shkaktohet përgjegjësi materiale për përmbaruesin ose që ka të bëjë me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njeriut, është i detyruar brenda 24 orëve nga lëshimi i urdhërit me gojë, të jap urdhër edhe me shkrim. Eprori udhëheqës nuk mund të nxjerrë një urdhër, zbatimin e të cilit paraqet një veper penale.

Personeli i shërbimit ushtarak dhe civil në Armatë, nëse marrin një urdhër, zbatimin e të cilit përbën një vepër penale, janë të detyruar që menjëherë të njoftojnë eprorin e lartë, për urdhërin e dhënë dhe të refuzojë zbatimin e urdhërit. Urdhëri i dhënë duhet të jetë i plotë, konciz dhe i qartë. Një urdhër me shkrim nënkupton gjithashtu një urdhër që transmetohet përmes mjeteve të komunikimit që lënë një shenjë të shkruar ose futen në dokumente të përcaktuara (libra, formularë, etj.). Me dhënien e një urdhëri, udhëheqësi është i detyruar të kujdeset për realizimin e tij.<sup>15</sup>

Sipas Kodit Penal të RM-së:

- (1) Personi zyrtar i cili gjatë kryerjes së detyrës që ka të bëjë me pengimin dhe zbulimin e veprave penale, zënien e kryerësve të veprave penale apo mbajtjen e rendit publik, paqes dhe sigurisë së vendit, nuk zbaton apo refuzon të zbatojë urdhër të eprorit që të ndërmerr ndonjë veprim zyrtar, dhe për këtë do të shkaktohet shkelje më të rëndë të të drejtave të tjetrit, prishje më të rëndë të rendit publik, paqes apo dëm të konsiderueshëm të pasurisë, do të denohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.
- (2) Personi zyrtar i cili nga pakujdesia nuk do ta zbatojë urdhërin e eprorit nga paragrafi 1, do të denohet me gjobë apo me burgim deri në një vjet.
- (3) Nuk ka vepër penale nëse personi zyrtar refuzon të zbatojë urdhër të kundërligjshëm.<sup>16</sup>

---

<sup>15</sup> Правило за начинот на издавање и извршување на наредби во Армијата на Република Македонија, Бр.06-810/3 од 07.05.2012 година

<sup>16</sup> Neni 353-b, paragrafi 1-3, fq.282, KPM.

## 1.6 TË PUNUARIT E PANDËRGJEGJSHËM GJATË DETYRËS

(1) Personi zyrtar apo përgjegjës në ndërmarrje apo në institucion publik I cili me shkelje të rregullave ligjore për konflikt të interesave apo për veprim të vetdijshëm gjatë kryerjes së autorizimit diskrecional, me lëshim të mbikqyrjes së detyruar apo në menyrë tjetër dukshëm vepron pandërgjegjshëm gjatë kryerjes së autorizimeve dhe detyrave të veta dhe me të do të përfitojë për vete apo për tjetërkënd ndonjë dobi apo tjetrit do t'i shkaktojë dëm, do të denohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

(2) Nëse kryerësi I veprës nga paragrafi 1 përfiton dobi më të madhe të pasurisë apo shkakton dëm të pasurisë apo më rëndë i shkel të drejtat e tjetrit, do të denohet me burgim prej gjashtë muaj në pesë vjet.

(3) Nëse kryerësi i vepres nga paragrafi 1 përfiton dobi të konsiderueshme të pasurisë apo shkakton dëm të konsiderueshëm, do të denohet me së paku tre vjet burgim.

(4) Me dënim nga paragrafët 1, 2 dhe 3 do të dënohet edhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik I cili ka përfaqësi në Republikën e Maqedonisë apo personi i cili kryen punë me karakter publik, nëse vepra është kryer gjatë kryerjes së autorizimit apo detyrës së posaçme të tij e përcaktuar me ligj.<sup>17</sup>

Meqenëse në përbërjen e këtyre veprave penale mbizotëron elementi i përfitimit personal, na shpie ne konkluzionin se të gjitha këto veprime apo mosveprime penale paraprihen apo shoqërohen nga një konflikt interesash. Pra, veprimi ose mosveprimi kriminal është i lidhur me një interes personal që ndeshet me interesin publik të zbatimit të ligjit.

Me nocionin “interes publik” nënkuptohet mbrojtja e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, parandalimi i rreziqeve për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe e natyrës, mbrojtja e pronësisë dhe e lirisë së tregut dhe sipërmarrësish, sundimi i së drejtës dhe parandalimi i krimit dhe korrupsionit.<sup>18</sup>Në një luftë interesash-nga një anë interesi publik dhe ushtrimi i detyrave sipas ligjit dhe nga ana tjetër interesi privat, i tunduar nga interesa personale monetare, materiale, privilegje etj,-

---

<sup>17</sup>Neni 353-c, paragrafi 1-4, fq.282-283, KPM.

<sup>18</sup> Ligji per parandalim te korrupsionit dhe konfliktit te interesave, Gazeta zyrtare e RM-se janar 2019, nr. 12, faqe 26, neni 8, paragrafi 8

zyrtari me veprimet dhe mosveprimet e tij zgjedh midis interesit personal apo atij publik. Në rastin më të keq, kur dominon interesi privat, veprimet ose mosveprimet në shkelje të ligjit dhe që kanë sjellë një përfitim apo kanë dëmtuar interesa të ligjshme të shtetasve ose shtetit, kualifikohen si vepër penale. Nëse për shkak të praktikës për raste të ngjashme, zyrtari do të ishte i ndërgjegjshëm se shkelja e ligjit dhe moskryerja e detyrave në përputhje me ndershmëri, paanësi, përgjegjësi etj, do të kishte si kosto së paku largimin e tij nga detyra, fenomeni i abuzimit me detyrën apo për shkak të detyrës, do të ulej ndjeshëm.

### **1.7 Evidenca statistikore për veprat penale kundër detyrës zyrtare nga organet e ndjekjes nga viti 2009 deri më 2014**

#### **Të Raportuar dhe të ndjekur penalisht për veprat penale kundër detyrës zyrtare**

Në këtë punim do të paraqes statistikat për veprat penale kundër detyrës zyrtare në përgjithësi, të raportuar, akuzuar dhe dënuar për periudhën nga viti 2009 deri më 2014. Këto të dhëna janë rezultat i sondazheve të rregullta vjetore statistikore nga Enti shtetëror i RM-së dhe ofrojnë informacion për kryerësit në të gjitha fazat e procedurës, nga paraqitja e rastit deri në gjykimin përfundimtar.

Të dhënat e paraqitura në punim u morën në bazë të anketave statistikore nga pyetëtorët individualë statistikorë të kompletuar nga zyrat e prokurorive publike kompetente dhe gjykatat themelore, ndërsa të përpunuara janë nga Enti shtetëror i statistikave.

Së pari, do të paraqes të dhëna për veprën penale keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar neni 353 i Kodit Penal për periudhën gjashtë vjeçare, si dhe numrin e të akuzuarve, gjegjësisht të gjykuarve për veprat penale në fjalë, për të bërë një krahasim dhe për të marrë një pasqyrë reale për kryerësit të raportuar në total.

**Të dhëna statistikore për veprën penale Keqpërdorimi pozitës dhe autorizimit zyrtar 2009-2014<sup>19</sup>**

**TABELA 1:**

VITI	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej
Janë paraqitur	940	916	692	724	774	457	4503
Femra	227	237	173	166	198	92	1093
Propozimakuze	343	247	150	162	188	133	1223
Janë akuzuar	291	192	267	254	189	291	1484
Femra	72	41	89	60	58	52	372
Procedura e ndërprerë	87	50	93	82	54	37	403
Të liruar nga akuza	40	29	75	30	23	39	236
Akuza e hudhur poshtë	37	23	24	39	20	22	165
Të gjykuar	127	90	75	103	92	193	680
Femra	20	15	15	21	20	35	126

Nga të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e numrit të veprave penale të kryera për periudhën 2009-2014 numri i personave të paraqitur në v. 2009-2010 ka qenë më i lartë në krahasim me vitet 2013-2014, ku ka numër të vogël të personave të paraqitur.

Nga pasqyra e këtyre të dhënave se në periudhën kohore 2009-2014, numri i personave të dënuar për veprën penale keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar është dukshëm më i vogël se sa ai i të dyshuarve. Numri i përgjithshëm i personave të dënuar për këtë vepër penale në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore në fjalë ishte 680 veta, nga të cilët 126 ishin femra.

Rritje të dallueshme në krahasim me vitet 2009-2010, ka në vitin 2014 ku janë dënuar 193 persona, nga të cilët 35 i përkasin gjinisë femërore.<sup>20</sup>

<sup>19</sup> Të dhënat statistikore janë siguruar nga Enti shtetëror për statistikë.

<sup>20</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.

## 1.8 Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e këtyre veprave penale

Personi zyrtar në zbatimin e autorizimeve dhe obligimeve publike është i detyruar të veprojë në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. Personi zyrtar në kryerjen e autorizimeve dhe obligimeve publike është i detyruar t'i respektojë parimet e ligjshmërisë, barazisë, efikasitetit, besimit, mëvetësisë, transparencës, objektivitetit, ndershmërisë dhe profesionalizmit dhe të veprojë me ndërgjegje, në mënyrë profesionale, pa diskriminim ose benefit ndaj cilitdo, me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe dinjitetit njerëzor, pa ndonjë interes privat.<sup>21</sup>

Pra, personi zyrtar, në parim veprimtarinë e tij duhet ta udhëheq nga disa elemente esenciale si: ligjshmëria, mbrojtja e interesave publike dhe të drejtave të personave privatë, barazia, drejtësia dhe paanshmëria, përgjegjshmëria, kontrolli i brendshëm, efektshmëria, etj.

Pasi që personi zyrtar është në krye të shërbimeve publike, subjekt kryesor në kryerjen e veprave penale në fjalë është vet personi zyrtar, gjegjësisht personi përgjegjës në institucionin përkatës, i cili e keqpërdor pozitën zyrtare duke i tejkaluar kufijtë e autorizimeve të veta.

Personi zyrtar duke ushtruar autoritetin e tij brenda institucionit publik mund të jetë i involvuar në vepra të tilla penale që duke përdorur pozitën e tyre për të i sjellë vetës ose tjetrit përfitime personale, pasurore bëjnë shkelje ose shpërdorim të autoritetit të tyre në kuadër të personit juridik (institucionit publik).

## 1.9 Raporti mes kryerësit dhe veprës penale

Pasi që kryerës i veprës penale kundër detyrës zyrtare është personi zyrtar, raporti me veprën penale zyrtare është shumë i ngushtë pasi që rrjedh nga vetë ai, nga vetë pozita zyrtare që ka, autorizimeve dhe pozicioneve të ndryshme brenda institucioneve shtetërore, varësisht nga hierarkia institucionale brenda institucionit. *Pra, kërkohet lidhja midis veprës penale të kryer dhe ushtrimit të detyrës zyrtare, funksionit menaxhues ose administrativ. Duhet që vepra të jetë kryer gjatë ushtrimit të profesionit apo veprimtarive dhe që kryerësi këto veprimtari t'i ketë shfrytëzuar si mjet apo si rrethanë për kryerjen e veprës penale.*<sup>22</sup>

---

<sup>21</sup>ЗАКОН ЗА СПРЕЧУВАЊЕ СУДИР НА ИНТЕРЕСИ Сл.Весник на Р.Македонија бр. 70 од 05.06.2007 година, член 4.

<sup>22</sup> I.Saliu, E drejta Penale, Prishtinë, 2005, fq.493

Kryerësit janë kryesisht persona të strukturës së lart shoqërore duke u zgjedhur si më profesionistët, me integritet moral dhe profesional, të shkolluar dhe edukuar. Personat të shtresave të larta janë të kyçur në të gjitha segmentet e pushtetit politik, ekonomik, financiar, gjyqësor dhe segmente tjera. Këta persona të cilët kanë autoritet për të ushtruar nga pozitat e larta shtetërore dhe duke e keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare kryejnë vepra penale duke u involvuar në kriminalitet, persona të tillë quhen kriminel të jakës së bardhë me status të lartë shtetëror. Kryerës të këtyre veprave penale në radhë të parë janë personat zyrtar dhe personat përgjegjës që ushtrojnë një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve në organe shtetërore. Ata janë përfaqësues të shtresave më të larta shtetërore, ata janë persona në pozita dhe me autoritet, titullarë funksionesh të larta shtetërore dhe ekonomike me autorizime të caktuara, persona në vende përgjegjëse, në afarizmin komercial, ekonomik dhe doganor; në qarkullimin e mallrave - agjentë tregtarë të cilët i shfrytëzojnë këto lidhje për qellime kriminale.

Personat zyrtarë që paraqiten si njerëz autoritativ, përfaqësues të qarqeve të larta e të respektuar, me autorizime të mëdha kanë raporte me kriminelë të ndryshëm në atë se u ndihmojnë, i furnizojnë me të dhëna të ndryshme të cilat janë me rëndësi për kryerjen e aktivitetit të tyre kriminal.

Individët e tillë, delikuentët i mbrojnë nga zbulimi dhe ndjekja e policisë, i lirojnë nga aktakuzat, i shpëtojnë nga gjykimi ose u ndihmojnë që të dalin para kohe nga vuajtja e denimit.

Veprat penale të përmendura më lartë mund të konsumohen vetëm gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe jashtë kësaj, këto vepra penale nuk ekzistojnë. Prandaj, vetë pozita e zyrtarëve e ndihmon raportin e kryerësit me veprën penale kundër detyrës zyrtare.

#### **1.10 Shkaqet të cilat ndikojnë në kryerjen e keqpërdorimit të pozitës zyrtare**

Për t'i shërbyer interesit publik është një mision thelbësor i qeverisë dhe institucioneve të tij publike. Qytetarët kanë të drejtë të presin që punonjësit individuale do të kryejnë detyrat e tyre me integritet, në një mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesa

të ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo persona të tjerë fizik edhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike. Zyrtarët që kanë interesa private gjatë mandatit të tyre mund të përbëjnë një kërcënim për këtë drejtë themelore. Ky konflikt interesi ka potencial për të dobësuar besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Një person zyrtar nuk mund të përdor detyrën e tij zyrtare për përfitimin e tij personal ose për atë të personave të tretë apo organizatave me të cilat ai është i lidhur personalisht. Pozita e një personi zyrtar ose statusi nuk duhet të përdoret për të detyruar; të miratojë ndonjë produkt, shërbim ose ndërmarrje; ose për të dhënë pamjen e sanksionit qeveritar. Një punonjës mund të përdorë titullin e tij zyrtar dhe pozitën vetëm në përgjigje të një kërkesë për një referencë ose rekomandim për dikë që ka kërkuar shërbim.

Sipas ligjit për konfliktin e interesave, “interes privat” nënkupton interes material ose jomaterial të personit zyrtar që mund të ndikojë mbi vendimmarrjen e tij gjatë kryerjes së punëve me interes publik.<sup>23</sup>

Pra, shkaqet që ndikojnë në ushtrimin e drejtë të detyrës zyrtare nga ana e zyrtarit janë interesat personale të cilat mund të përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:

- a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;
- b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

ç) negociime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negociime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijojnë të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitim prurëse dhe jo fitim prurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;

dh) marrëdhënie:

- i) familjare apo të bashkëjetesës;

---

<sup>23</sup> ЗАКОН ЗА СПРЕЧУВАЊЕ СУДИР НА ИНТЕРЕСИ Сл.Весник на Р.Македонија бр. 70 од 05.06.2007 година, член 3, алинеа 4.



- ii) të komunitetit;
- iii) etnike;
- iv) fetare;
- v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;

e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesat e përmendura më lartë.

Pra, çdo lloj interesi privat i një zyrtari nga ata të përcaktuar më sipër, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi.<sup>24</sup>

### 1.11 Profili i kryerësve të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar

#### 1.11.1 Moshë, gjinia dhe përkatësia etnike e të denuarve

Nga karakteristikat që e përcaktojnë profilin e kryerësve të veprave penale kundër detyrës zyrtare përfshihen pyetje si moshë, gjinia dhe përkatësia etnike, si dhe arsimimi i tyre.

Në aspektin e strukturës së moshës të përfaqësuar janë grupmoshat prej 18 vjet e deri 60 vjet e sipër.

**TABELA 2**  
**Moshë, gjinia dhe përkatësia etnike e të denuarve**

Viti	2009		2010		2011		2012		2013		2014	
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
Gjinia												
Moshë												
18-20vjet	2	/	1	/	/	/	1	/	/	/	1	/
21-24vjet	5	/	/	1	/	1	2	2	1	1	5	/
25-29vjet	14	1	5	/	5	3	13	2	13	1	11	1
30-39vjet	32	5	35	7	17	3	25	12	18	2	40	9
40-49vjet	55	11	38	10	38	10	38	9	49	11	74	19
50-59vjet	28	6	28	3	39	11	30	5	22	10	51	14
Mbi 60vjet	4	/	14	/	11	/	6	1	6	2	7	2
Te panjohur	3	/	/	/	/	/	3	1	1	/	8	1
<b>Gjithsej</b>	<b>143</b>	<b>23</b>	<b>121</b>	<b>21</b>	<b>110</b>	<b>34</b>	<b>118</b>	<b>32</b>	<b>110</b>	<b>27</b>	<b>197</b>	<b>46</b>

<sup>24</sup> Fjorida Ballauri (Kallço), Konflikti i interesave në veprat penale të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, Disertacion për mbrojtje e gradës shkencore “DOKTOR”, Tiranë, 2015, faqe 15.

Sipas gjinisë, numri shumë më i madh i të akuzuarve janë meshkuj, ndërsa numer më i vogël i të akuzuarve janë të gjinisë femërore. Lidhur me pyetjen për moshën, nga praktika vërehet se kryerësit më të shpeshtë janë të moshës 30 deri në 59 vjet që kanë pozita dhe kompetenca të larta në organin ku punojnë. Edhe pse janë të përfaqësuar gati të gjithë grupmoshat, prapëseprap në përqindje më të madhe si kryerës të veprave penale kundër detyrës zyrtare paraqiten personat të cilat i takojnë grupmoshës 45 deri 55 vjet dhe prej 36 deri 45 vjet. Më e vogël është pjesëmarrja e grupmoshës prej 18 deri 25 vjet dhe të asaj mbi 60 vjet.<sup>25</sup>

**TABELA 3**  
**Të denuar sipas perkatësisë etnike**

Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Përkatsia etnike						
Maqedon	132	126	111	93	94	189
Shqiptar	22	7	10	36	18	25
Turq	/	3	2	/	1	1
Rom	/	1	1	2	4	1
Vlleh	/	1	1	1	1	1
Serb	1	1	2	2	1	1
Boshnjak	/	/	/	/	1	/
Të tjerë	4	3	1	2	1	3
Të panjohur	8	/	4	14	16	22

Në bazë të të dhënave statistikore rezulton se pjesa më e madhe e kryerësve të veprave penale kundër detyrës zyrtare për nga përkatsia etnike janë maqedonas, gjithsej 745 persona. Pjesëmarrja e personave me përkatësi shqiptare për nga numri i periudhes kohore në fjalë gjithsej janë 118 persona, përderisa pjesëmarrja e personave me përkatësi kombëtare rome ose kombësi tjetër është me numër të ulët.<sup>26</sup>


### 1.11.2 Shkalla e arsimimit

Evidencat statistikore tregojnë se përqindja më e madhe e kryerësve janë me fakultet por i madh është edhe numri i atyre kryerësve të cilët janë me shkollim të mesëm. Si kryerës të

<sup>25</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.

<sup>26</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.

veprave penale kundër detyrës zyrtare, më rrallë paraqiten persona me shkolle të lartë dhe arsim fillor.




### 1.11.3. Organet në të cilat kryhet V.P. Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar

Sipas të dhënave të hulumtimit rezulton se keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar është i përfaqësuar në të gjitha fushat e shoqërisë, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. Keqpërdorimi pozitës bëhet kryesisht nga menaxherët dhe punonjësit e ndërmarrjeve publike, pastaj në ministritë, komuna, gjykata, arsim dhe autoritetet e tjera qeveritare dhe në shoqëri aksionare, Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në organet e administratës shtetërore, në gjykatat dhe organet dhe organizatat e tjera që kryejnë punë të caktuara profesionale, administrative dhe punë të tjera në suazat e të drejtave dhe obligimeve të Republikës së Maqedonisë, në komunat dhe në Qytetin e Shkupit, si dhe personat e tjerë që kryejnë autorizime publike.

### 1.12. Sanksionet që u janë shqiptuar kryerësve të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar


Nga të dhenat statistikore për sanksionet që u janë shqiptuar kryerësve të veprës penale keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar gjatë periudhës 2009-2014, rezulton si vijon:

#### Viti 2009




Në vitin 2009 janë shqiptuar 41 denime kryesore, edhe atë: me burg janë denuar 36 ndërsa me gjobë 5 kryerës. Me denime sekondare janë denuar 2 kryerës (me gjobë). Masat alternative janë shqiptuar ndaj 84 kryerësve, edhe atë: me burg janë denuar 77, me gjobë 2 dhe me vërejtje gjyqsore 5 kryerës. Masat e sigurisë janë shqiptuar ndaj 5 kryerësve, prej të cilëve 4 janë denuar me konfiskim të pasurisë ndërsa 1 kryerës me marrjen e objekteve.

## Viti 2010




Në vitin 2010 janë shqiptuar 30 denime kryesore, edhe atë: me burg janë denuar 25 ndërsa me gjobë 5 kryerës. Me denim sekondar është denuar 1 kryerës (me ndalim ushtrimi të profesionit). Masat alternative janë shqiptuar ndaj 59 kryerësve, edhe atë: me burg janë denuar 58 dhe me vërejtje gjyqsore 1 kryerës. Masat e sigurisë janë shqiptuar ndaj 6 kryerësve, prej të cilëve 2 janë denuar me konfiskim të pasurisë ndërsa 4 kryerës me marrjen e objekteve. Pra, nga të dhenat statistikore mund të vërehet se në krahasim me vitin 2009, në vitin 2010 ka ulje të numrit të kryerësve të veprës penale keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar.

## Viti 2011




Në vitin 2011 janë shqiptuar 23 denime kryesore, edhe atë: me burg janë denuar 21 ndërsa me gjobë 2 kryerës. Me denime sekondare janë denuar 3 kryerës me gjobë. Masat alternative janë shqiptuar ndaj 49 kryerësve, edhe atë: me burg janë denuar 48 dhe me gjobë 1 kryerës. Masat e sigurisë janë shqiptuar ndaj 7 kryerësve, prej të cilëve 3 janë dënuar me konfiskim të pasurisë ndërsa 4 kryerës me marrjen e objekteve.

## Viti 2012



Në vitin 2012 janë shqiptuar 40 denime kryesore, edhe atë: me burg janë denuar 21 ndërsa me gjobë 19 kryerës. Me denime sekondare janë denuar 2 kryerës (me gjobë). Masat alternative janë shqiptuar ndaj 61 kryerësve, edhe atë: me burg janë denuar 61 kryerës. Masat e sigurisë janë shqiptuar ndaj 21 kryerësve, prej të cileve 6 janë denuar me konfiskim të pasurisë ndërsa 15 kryerës me marrjen e objekteve.


## Viti 2013



Në vitin 2013 janë shqiptuar 27 denime kryesore, edhe atë: me burg janë denuar 22 ndërsa me gjobë 5 kryerës. Masat alternative janë shqiptuar ndaj 65 kryerësve, edhe atë me burg. Masat e sigurisë janë shqiptuar ndaj 23 kryerësve, prej të cilëve 10 janë denuar me konfiskim të pasurisë ndërsa 13 kryerës me marrjen e objekteve. Pra, nga të dhënat statistikore mund të vërehet se në krahasim me vitin 2011 dhe 2012, 2010 ka ulje të numrit të kryerësve të veprës penale keqpërdorimi i pozites dhe autorizimit zyrtar.



## Viti 2014



Në vitëin 2014 janë shqiptuar 79 denime kryesore, edhe atë: me burg janë denuar 71 ndërsa me gjobë 8 kryerës. Me denime sekondare janë denuar 10 kryerës: 9 me ndalim ushtrimi profesioni ndërsa 1 kryerës me ndalim drejtimi automjeti. Masat alternative janë shqiptuar ndaj 104 kryerësve, edhe atë: 104 kryerës janë denuar me burg. Masat e sigurisë janë shqiptuar ndaj 138 kryerësve, prej të cilëve 66 janë denuar me konfiskim të pasurisë ndërsa 72 kryerës me marrjen e objekteve. Pra, nga të dhënat e paraqitura për periudhën 2009-2014 nga Enti statistikor i Republikës së Maqedonisë, mund të vërehet se në krahasim me vitin 2013 por edhe vitet tjera, në vitin 2014 ka rritje të numrit të kryerësve të veprës penale keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar.<sup>27</sup>

<sup>27</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.

## KAPITULLI I DYTË

### 2.1. NOCIONI I VEPRËS PENALE KEQPËRDORIMI I SHËRBIMIT

Ashtu siç e kemi përmendur dhe në hyrje të këtij punimi, në fokus të këtij studimi janë ato vepra penale të kryera nga nëpunësit publikë, të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre krijojnë një përfitim të padrejtë për vete apo të tjerë.

Në parim, që një zyrtar të bjerë në konflikt interesi për shkak të interesit privat, prezumohet se ky interes privat që dominon mbi atë publik, është një interes më i lartë se vazhdimësia e ushtrimit të detyrës publike. Pra, zyrtari në rastin e shkeljes së ligjit vepron nisur nga dy arsye kryesore, ose është i garantuar se pavarësisht shkeljes, nuk do të ketë pasoja ose interesi tjetër i cili e shtyn drejt shkeljes është aq i madh sa mund ta “justifikojë” për të humbjen e funksionit. Rastet e tjera, kur zyrtari vepron me risk, pra me idenë se “shkelja nuk do të zbulohet” teorikisht duhet të jenë të rralla apo sporadike, por mund të kthehen në fenomene si efekti “domino” nëse shkeljet nuk evidentohen dhe rastet nuk ndëshkohen.

Nëse për shkak të praktikës për raste të ngjashme, zyrtari do të ishte i ndërgjegjshëm se shkelja e ligjit dhe moskryerja e detyrave në përputhje me ndershmëri, paanësi, përgjegjësi etj, do të kishte si kosto së paku largimin e tij nga detyra, fenomeni i abuzimit me detyrën apo për shkak të detyrës, do të ulej ndjeshëm.

#### **Sipas kodit penal te Republikës së Maqedonisë neni 354:**

- (1) Personi zyrtar i cili me qëllim që të përfitojë për vete ose për tjeterkënd dobi të kundërligjshme të pasurisë do të përvetësoj para, letra me vlerë apo sende tjera të luajtshme të besuara në shërbim, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- (2) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 ka përfituar dobi më të madhe të pasurisë, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (3) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 ka përfituar dobi të konsiderueshme të pasurisë, do të dënohet më së paku katër vjet burgim.
- (4) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 ka përfituar dobi të vogël pasurie dhe ka shkuar nga ajo që të përfitojë dobi të atillë të pasurisë, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.

(5) Me dënimin nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik që ka përfaqësi në Republikën e Maqedonisë apo personi i cili kryen punë me karakter publik, nëse vepra është kryer gjatë kryerjes së autorizimit apo detyrës së tij të posaçme, e caktuar me ligj.<sup>28</sup>

Fusha e veprimit të saj përfshin të gjithë veprimtarinë e zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike dhe gjithë rrethin e detyrave të tyre, pra është shumë i gjerë. Objekt i kësaj vepre penale janë ato “marrëdhënie juridike të vendosura me ligj ose me akte nënligjore që sigurojnë veprimtarinë normale të aparatit shtetëror dhe mbrojtjen e të drejtave të interesave të ligjshme të shtetasve ose të shtetit”<sup>29</sup>. Kjo vepër penale si rregull kryhet nëpërmjet veprimeve aktive të zyrtarëve publikë në kundërshtim me ligjin ose aktet nënligjore dhe me përmbushjen e rregullt të detyrës së tij, por nuk përjashtohen edhe format e neglizhencës ose kryerjen e saj me anë të mosveprimit.

Vepra penale e shpërdorimit të detyrës, shpesh mund të jetë rrjedhojë e konfliktit të interesit dhe është e ngjashme me veprat e tjera penale, si shkelja e barazisë në tendera, ose korrupsioni pasiv, ku zyrtarët me veprimet ose mosveprimet e tyre përfitojnë shpërblime, marrin premtime apo favore në shkëmbim të qëndrimit të tyre në një vendimmarrje. Interesat private që mund të ndikojnë në një vendimmarrje të caktuar mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga interesi në marrëdhënie juridike civile ku zyrtari ka pjesë, e deri në marrëdhënie familjare apo të bashkëjetesës, të komunitetit, etnike, fetare, të miqësisë etj.

Pra, veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në përfitimin e parave, letrave me vlerë apo sendeve tjera të luajtshme me qëllim të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme. Për tu konsideruar se ekziston kjo vepër nevojitet që këto sende t’i jenë besuar kryerësit në shërbim (në ruajtje, materiali i zyrës, mjetet teknike, para në arkë) si dhe të gjendet në pronësi të kryerësit në momentin e kryerjes së veprës. Lidhur me fajësinë, kjo vepër penale mund të kryhet me dashje e cila duhet të përfshijë edhe vetëdijen e kryerësit të veprës penale se dëshiron të përvetësojë pasuri të kundërligjshme.

---

<sup>28</sup> Neni 354, KPM

<sup>29</sup> Per më tepër shih: E drejta penale (pjesa e posaçme), Ismet Elezi, botim I vitit 2008, faqe 440.

## **2.2. Mashtrimi gjatë shërbimit**

- (1) Personi zyrtar i cili gjatë kryerjes së shërbimit me qëllim që për vete apo për tjetërkënd të përfitojë dobi të kundërligjshme të pasurisë me paraqitje të përlllogaritjeve të rrejshme apo në mënyrë tjetër do ta sjellë në lajthim personin e autorizuar të bëjë pagesë të paligjshme, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- (2) Nëse me veprën nga paragrafi 1 është përfituar dobi më të madhe të pasurisë, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (3) Nëse me veprën nga paragrafi 1 është përfituar dobi e konsiderueshme e pasurisë, kryerësi do të dënohet me së paku tre vjet burgim.
- (4) Me denim nga paragrafët 1, 2 dhe 3 do të dënohet edhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik që ka përfaqësi apo kryen veprimtari në Republikën e Maqedonisë, apo personi që kryen punë me karakter publik, nëse vepra është kryer gjatë kryerjes së autorizimit apo detyrës së posaçme të tij.<sup>30</sup>

## **2.3. Te shërbyerit gjatë detyrës**

Personi zyrtar i cili pa autorizim do të shërbehet me para, me letra me vlerë apo mjete të tjera të luajtshme të besuara në shërbim ose këto mjete pa autorizim do t'ia japë tjetërkujt në shërbim, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.<sup>31</sup>

## **2.4. Evidencat statistikore nga organet e ndjekjes**

### **TABELA 4**

**Të Raportuar dhe të ndjekur penalisht për veprën penale keqpërdorimi i shërbimit nga viti 2009 deri me 2014**

---

<sup>30</sup> Neni 355, KPM

<sup>31</sup> Neni 356, KPM

Nga të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e numrit të veprave penale ne fjale të kryera për periudhën 2009-2014, numri i personave të paraqitur në v. 2009-2010-2011 ka qenë më i ulet në krahasim me vitet 2012-2013-2014, ku ka rritje të numrit te personave të paraqitur.

VITI	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej
Janë paraqitur	14	16	12	22	16	21	101
Femra	4	3	1	5	9	5	27
Propozimakuze	12	8	5	10	7	18	60
Janë akuzuar	10	6	12	10	12	9	59
Femra	2	1	3	1	4	4	15
Procedura e ndërprerë	-	-	1	-	1	-	2
Të liruar nga akuza	-	-	-	-	2	-	2
Akuza e hudhur poshtë	-	-	1	-	-	-	1
Të gjykuar	10	6	10	10	9	9	54
Femra	2	1	3	1	3	4	14

Nga pasqyra e këtyre të dhënave në periudhën kohore 2009-2014, numri i personave të dënuar për veprën penale keqpërdorimi i shërbimit është dukshëm më i vogël se sa ai i të dyshuarve. Numri i përgjithshëm i personave të dënuar për këtë vepër penale në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore në fjalë ishte 54 persona, nga të cilët 14 ishin femra.<sup>32</sup>

## 2.5. Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e këtyre veprave penale

Nga vet fakti që veprat penale kundër detyrës zyrtare, ndahen në vepra penale të cilat mund të kryhen vetëm nga personat zyrtar dhe veprat penale të cilat mund t'i kryejnë edhe personat të cilët nuk e kanë cilësinë e personit zyrtar apo personit përgjegjës, pra është personi zyrtar

<sup>32</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година

dhe çdo person tjetër fizik, i cili është subjekt pasiv në kryerjen e veprës penale me të cilën i është dëmtuar ose rrezikuar të drejtat dhe interesat e tij. Kryerës të këtyre veprave penale në radhë të parë janë personat zyrtar dhe personat përgjegjës që ushtrojnë një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve në organe shtetërore. Ata janë përfaqësues të shtresave më të larta shtetërore, ata janë persona në pozita dhe me autoritet, titullarë funksionesh të larta shtetërore dhe ekonomike me autorizime të caktuara, persona në vende përgjegjëse, në afarizmin komercial, ekonomik dhe doganor; në qarkullimin e mallrave - agentë tregtarë, brigadierë etj. Punonjësit shtetërore ose në shërbim publik, të cilët gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, të ndikuar nga interesat private, mund të veprojnë në kundërshtim me ligjin, duke shkaktuar pasoja për individët, shoqëritë tregtare dhe për shtetin në tërësi.

## **2.6. Raporti mes kryerësit dhe veprës penale**

Elementi që mund të lidhë këtë vepër penale me një situatë konflikti interesi është përfitimi i parregullt, i cili buron nga interesa private të ndryshme të lartpërmendur. Kështu në tërësinë e interesave private që ndikojnë në vendimmarrje të zyrtarëve marrim si shembull rastin e emërimit/rekrutimit të një punonjësi, që nuk plotëson kriteret e eksperiencës në punë për pozicionin ku konkuron, për shkak se është familjar i bashkëshortes së titullarit të institucionit.

Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mos veprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk duhet të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo persona të tjerë fizike dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike.

Nga mosveprimi i zyrtareve kanë ardhur pasoja të dëmshme (*përfitime materiale të padrejta, dëmtime të interesave të ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridik*) dhe lidhet me veprime të tjera që plotësojnë lidhjen shkak pasojë, janë elemente të mjaftueshme për të konsideruar të konsumuar veprën penale të keqpërdorimit të detyrës.

Pra, identifikimi i interesit privat, që ka çuar zyrtarin në shkeljen e ligjit do të ishte një ndër elementët kryesorë për të provuar ekzistencën e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës apo përfitimit të paligjshëm të interesave.

## **2.7. Shkaqet të cilat ndikojnë në keqpërdorimin e shërbimit**

Zyrtari udhëhiqet në vendimmarrjen e tij nga marrëdhënie që burojnë nga interesa politike, miqësisë apo armiqësisë, të komunitetit, etnike, fetare etj.

Punësimi në një vend tjetër në rastet kur interesat e një pozicioni punë konfliktohen me ato të një vendi tjetër pune. Interesat familjare në të cilat bashkëshorti, fëmija apo një i afërm janë të punësuar (apo aplikojnë për punësim) ose kur mallrat ose shërbimet blihen nga një i afërm apo një firmë e kontrolluar nga një familjari zyrtarit. Dhuratat dhe miqtë, të cilët gjithashtu bëjnë biznes me personin që merr këto dhurata.

Këto dhurata mund të përfshijnë edhe vlera të llojeve të tjera, të dhëna në formën e udhëtimeve, trajtimeve preferenciale apo kredi të ndryshme.

Pagat e ulëta të funksionarëve dhe punonjësve publik, koncepti materialist për arritjen e përfitimit të pandershëm dhe të suksesit me anë pushteti, paraje, pozite shoqërore, janë disa nga shkaqet e shumta që ndikojnë në keqpërdorimin e shërbimit nga ana e personit zyrtar.

## **2.8. Profili I kryerësve të veprës penale keqpërdorimi i shërbimit**

### **2.8.1. Moshë, gjinia dhe përkatësia etnike**

Nga karakteristikat që e përcaktojnë profilin e kryerësve të veprave penale kundër detyrës zyrtare përfshihen pyetje si moshë, gjinia dhe përkatësia etnike, si dhe arsimimi i tyre.

Në aspektin e strukturës së moshës të përfaqësuar janë grupmoshat prej 18 vjet e deri 60 vjet e sipër.

Sipas gjinisë, numri shumë më i madh i të akuzuarve janë meshkuj, ndërsa numër më i vogël i të akuzuarve janë të gjinisë femërore.

Lidhur me pyetjen për moshën, nga praktika vërehet se kryerësit më të shpeshtë janë të moshës 30 deri në 59 vjet që kanë pozita dhe kompetenca të larta në organin ku punojnë. Edhe pse janë të përfaqësuar gati të gjithë grupmoshat, prapëseprap në përqindje më të madhe si kryerës të veprave penale korruptuese paraqiten personat të cilat i takojnë grupmoshës 45 deri 55 vjet dhe prej 36 deri 45 vjet. Më e vogël është pjesëmarrja e grupmoshës prej 18 deri 25 vjet dhe të asaj mbi 60 vjet.

### **2.8.2. Shkalla e arsimimit**

Evidencat statistikore tregojnë se përqindja më e madhe e kryerësve janë me fakultet por i madh është edhe numri i atyre kryerësve të cilët janë me shkollim të mesëm. Si kryerës të veprave penale kundër detyrës zyrtare, më rrallë paraqiten persona me shkollë të lartë dhe arsim fillor.


### **2.9 Organet në të cilat kryhet V.P. Keqpërdorimi i shërbimit**

Sipas të dhënave të hulumtimit rezulton se keqpërdorimi i shërbimit është i përfaqësuar në të gjitha fushat e shoqërisë, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. Keqpërdorimi pozitiv bëhet kryesisht nga menaxherët dhe punonjësit e ndërmarrjeve publike (55%), pastaj në ministritë, komuna, gjykata, arsim dhe autoritetet e tjera qeveritare (16%), dhe në shoqëri aksionare (10%). Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në organet e administratës shtetërore, në gjykatat dhe organet dhe organizatat e tjera që kryejnë punë të caktuara profesionale, administrative dhe punë të tjera në suazat e të drejtave dhe obligimeve të Republikës së Maqedonisë, në komunat dhe në Qytetin e Shkupit, si dhe personat e tjerë që kryejnë autorizime publike.


### **2.10 Sanksionet që u janë shqiptuar kryerësve të veprës penale keqpërdorimi i shërbimit prej vitit 2009 deri më 2014**

Nga të dhënat statistikore për sanksionet që u janë shqiptuar kryerësve të veprës penale keqpërdorimi i shërbimit gjatë periudhës 2009-2014, rezulton si vijon:






Në vitin 2009 gjithsej janë shqiptuar 10 denime, prej të cilëve 8 kryerës janë meshkuj ndërsa 2 janë femra. Denime kryesore u janë shqiptuar 2 kryereëve, gjegjësisht 2 kryerës janë denuar me burg. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 8 kryerësve, gjegjësisht me burg janë denuar 8 kryerës.




Në vitin 2010 janë shqiptuar gjithsej 6 denime, prej të cilëve 5 kryerës kanë qenë meshkuj ndërsa 1 kryerës femër. Me denim kryesor burg është denuar 1 kryerës, ndërsa me masë alternative, gjegjësisht burg janë denuar 5 kryerës.




Në vitin 2011 janë shqiptuar gjithsej 10 denime, prej të cilëve 7 kryerës kanë qenë meshkuj ndërsa 3 femra. Me denime kryesore janë denuar 4 kryerës edhe atë: 3 me burg dhe 1 kryerës me gjobë, ndërsa me masë alternative, gjegjësisht burg janë denuar 6 persona.



Në vitin 2012 kryerësve u janë shqiptuar gjithsej 10 denime, prej të cilëve 9 kryerës kanë qenë meshkuj ndersa 1 kryerës ka qenë femër. Me denim kryesor burg janë denuar 6 kryerës, ndërsa me masë alternative, gjegjësisht burg janë denuar 4 kryerës.



Në vitin 2013 kryerësve u janë shqiptuar gjithsej 9 denime, prej të cilëve 6 kryerës kanë qenë meshkuj ndërsa 3 kryerës kanë qenë femra. Me denim kryesor burg janë denuar 4 kryerës, ndërsa me masë alternative, gjegjësisht burg janë denuar 5 kryerës.



Në vitin 2014 kryerësve u janë shqiptuar gjithsej 9 denime, prej të cilëve 5 kryerës kanë qenë meshkuj ndërsa 4 kryerës kanë qenë femra. Me denim kryesor burg janë denuar 4 kryerës, ndërsa me masë alternative, gjegjësisht burg janë denuar 5 kryerës.<sup>33</sup>

## KAPITULLI I TRETË

### MARRJA DHE DHËNIA E RYSHFETIT

#### 3.1. Nocioni i veprës penale marrja dhe dhënia e ryshfetit

Për një shoqëri demokratike të organizuar nuk ka gjë më të rrezikshme se marrja e ryshfetit nga ana e bartësve të funksioneve të shërbimeve publike. Marrja e ryshfetit nga ana e këtyre personave paraqet një formë të korrupsionit.<sup>34</sup>

Me korrupsion nenkuptojmë çdo shfrytëzim të funksionit, te autorizimit zyrtar, detyrës dhe pozitës zyrtare, me qëllim të arritjes së përfuturit të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin.<sup>35</sup>

I përkufizuar shumë thjeshtë, korrupsioni është keqpërdorimi i fuqisë të besuar publike për përfitim personal.<sup>36</sup>

Korrupsioni në rradhët e administratës publike shfaqet më së shumti kur ekzistojnë kushtet dhe faktorët ekonomikë dhe socialë. Së pari, ai mund të fillojë nga një rryshfet i ofruar një nëpunësi apo kur nëpunësi kërkon një pagesë të jashtë ligjshme. Ai që ofron rryshfetin e bën këtë sepse kërkon diçka për të cilën s'ka të drejtë (dhe i jep rryshfet nëpunësit që të shkelë rregullat), ose sepse mendon që nëpunësi nuk do t'i japë atë që i takon nëse nuk i ofron diçka. Marrja e parave, një dhuratë ose kundër të tjera favor, përveç (ose në vend të) tarifës së nevojshme zyrtare, për përfitime personale të nëpunësit civil paraqet një akt të një ryshfeti administrativ.

#### 3.2. Marrja e ryshfetit neni 357

Lufta kundër korrupsionit në arenën ndërkombëtare është mjaft e pranishme, sepse vet korrupsioni dhe format e tij paraqet një pengesë të madhe në realizimin e parimeve bazë, që

<sup>33</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.

<sup>34</sup> I.Zejneli, E drejta Penale (pjesa e posacme), Tetov, 2007, fq.153

<sup>35</sup> Ligji per parandalim te korrupsionit dhe konfliktit te interesave, Gazeta zyrtare e RM-se janar 2019, nr. 12, faqe 25, neni 2, paragrafi 1

<sup>36</sup> JJ.Senturia, Enciklopedia e shkencave sociale,vol VI 1993

është sundimi i ligjit dhe shtetit ligjor. Rryshfeti është zakonisht një akt kriminal korruptiv që shfaqet në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë në dy forma, si pranimi dhe dhënia e rryshfetit. Personi zyrtar i cili drejtëpërdrejtë apo tërthorazi do të kërkojë apo do të pranojë dhuratë apo dobi tjetër ose do të pranojë premtim për dhuratë apo dobi tjetër për vete apo për tjetërkënd që në suaza të autorizimit të vet zyrtar të kryejë ndonjë veprim zyrtar që nuk do të guxonte ta kryejë apo të mos e kryejë veprim zyrtar që duhet të kryejë, do të dënohet me së paku katër vjet burgim.

(1) Personi zyrtar i cili drejtëpërdrejtë apo tërthorazi do të kërkojë apo do të pranojë dhuratë apo dobi tjetër ose do të pranojë premtim për dhuratë apo dobi tjetër për vete apo për tjetërkënd, që në suaza të autorizimit të vet zyrtar të kryejë ndonjë veprim zyrtar që duhet ta kryejë apo të mos kryejë veprim zyrtar që nuk guxon ta kryejë, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(2) Personi zyrtar i cili pas kryerjes ose moskryerjes së veprimit zyrtar të caktuar në paragrafët 1 dhe 2 lidhur me atë do të kërkojë apo do të pranojë dhuratë apo dobi tjetër, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

(3) Nëse me veprën është fituar dobi më të madhe pasurore, kryerësi do të dënohet me së paku katër vjet burgim.

(4) Nëse me veprën është fituar dobi të konsiderueshme pasurore, kryerësi do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(5) Me dënim nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës i cili kryen punë me karakter publik, personi përgjegjës në personin e huaj juridik, si dhe personi i huaj zyrtar nëse vepra është kryer me shkeljen e autorizimeve të tij, lidhur me fitimin, realizimin apo marrjen e të drejtave të caktuara me ligj apo për shkak të fitimit të dobisë apo shkaktimit të dëmit tjetërkujt.

(6) Dhurata apo dobia pasurore e pranuar do të merren.<sup>37</sup>

### **3.3. Dhënia e rryshfetit neni 358**

(1) Ai i cili drejtëpërdrejtë apo tërthorazi personit zyrtar do t'i japë apo do t'i ofrojë dhuratë apo dobi tjetër për atë ose për tjetërkënd që në suaza të autorizimit të vet zyrtar të

---

<sup>37</sup> Neni 357, KPM

kryejë veprim zyrtar që nuk guxon ta kryejë ose të mos kryejë veprim zyrtar që është dashur ta kryejë apo ai i cili ndërmjetëson në këtë, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

- (2) Ai i cili drejtpërdrejtë apo tërthorazi personit zyrtar do t'i japë apo do t'i ofrojë dhuratë apo dobi tjetër për atë ose për tjetërkënd që në suaza të autorizimit të vet zyrtar të kryejë veprim zyrtar që duhet ta kryejë apo të mos kryejë veprim zyrtar që nuk guxon ta kryejë apo ai i cili ndërmjetëson në këtë, do të dënohet me dënim me gjobë ose me burgim deri tre vjet.
- (3) Për veprën penale nga paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk do të dënohet ai i cili ka dhënë apo ka premtuar ryshfet me kërkesë të personit zyrtar, dhe atë e paraqet para se të dijë se vepra është zbuluar.
- (4) Dispozitat nga paragrafët 1, 2 dhe 3 zbatohen edhe kur ryshfeti i është dhënë apo premtuar personit përgjegjës, personit përgjegjës në personin e huaj juridik, personit i cili kryen punë me karakter publik dhe personit të huaj zyrtar lidhur me veprën nga neni 357.
- (5) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë.
- (6) Dhurata apo dobia e pasurisë e dhënë do të merren, kurse në rastin nga paragrafi 3 do t'i kthehen personit i cili e ka dhënë ryshfetin.<sup>38</sup>

#### **3.4. Ndërmjetësimi i kundërligjshëm Neni 359**

- (1) Ai i cili do të pranojë dhuratë apo dobi tjetër me shfrytëzimin e pozitës dhe të ndikimit të vet zyrtar apo shoqëror për të ndërmjetësuar të kryhet apo të mos kryhet ndonjë veprim zyrtar, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (2) Ai i cili me shfrytëzimin e pozitës apo ndikimit të vet zyrtar apo shoqëror do të ndërmjetësojë të kryhet ndonjë veprim zyrtar që nuk guxon të kryhet apo të mos kryhet veprim zyrtar që duhet të kryhet, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

---

<sup>38</sup> Neni 358, KPM

- (3) Nëse vepra nga paragrafi 2 është kryer në lidhje me ngritjen apo zhvillimin e procedurës penale kundër personit të caktuar, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (4) Ai i cili me shfrytëzimin e pozitës së vet, apo ndonjë pozite tjetër, autoritetit të përgjithshëm apo ndikimit, për dhuratë apo dobi tjetër ndërmjetëson te personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik që kryen veprimtari në Republikën e Maqedonisë apo personi i cili kryen punë me karakter publik të kryejë apo të mos kryejë veprim që është në kundërshtim me detyren e tij, qytetarëve apo personit juridik, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.
- (5) Nëse vepra nga paragrafi 4 ka pasur për pasojë apo humbje të të drejtave të kundërligjshme, apo fitim të dobisë më të madhe pasurore apo shkaktim dëm më të madh tjetërkujt, personit të vendit apo të huaj juridik, kryerësi do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.
- (6) Nëse për ndërmjetësimin nga paragrafët 2 dhe 3 është pranuar shpërblim apo dobi tjetër, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (7) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.<sup>39</sup>

### **3.5. Fitimi i kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur neni 359-a**

- (1) Personi zyrtar dhe personi përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik apo në person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, i cili në kundërshtim me detyrën ligjore për paraqitjen e gjendjes së pasurisë apo ndryshimit të saj, do të jep të dhëna të rrejshme apo jo të plota për pasurinë e vet apo pasurinë e anëtarëve të familjes së vet, e cila në vlerë të konsiderueshme i tejkalon të hyrat e tij ligjore, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me dënim me gjobë.
- (2) Me dënimin nga paragrafi 1 të këtij neni do të dënohet personi zyrtar apo personi përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik apo në person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, i cili, kur në procedurë të rregulluar ligjore do të

---

<sup>39</sup> Neni 359, KPM

vërtetohet se gjatë kryerjes së funksionit apo detyrës ai apo anëtar të familjes së tij ka fituar pasuri që në vlerë të konsiderueshme i tejkalon të hyrat e tij ligjore, jep të dhëna të rrejshme apo i mbulon burimet e tij të vërteta.

- (3) Nëse vepra nga paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni është kryer lidhur me pasurinë që në përmasa të mëdha i tejkalon të hyrat e tij ligjore, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në tete vjet dhe me dënim me gjobë.
- (4) Për veprat nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni kryerësi nuk do të dënohet nëse në procedurë para gjyqit jep sqarim të pranueshëm për origjinën e pasurisë.
- (5) Pasuria e cila i tejkalon të hyrat që kryerësi në mënyrë ligjore i ka realizuar dhe për të cilat ka dhënë të dhëna apo i mbulon burimet e tij të vërteta, konfiskohet, nëse konfiskimi i tij nuk është i mundshëm, nga kryerësi konfiskohet pasuri tjetër e tij që përgjigjet në vlerën e tij.
- (6) Pasuria nga paragrafi 5 të këtij neni konfiskohet edhe nga anëtarët e familjes së kryerësit për të cilët është realizuar apo mbi të cilët është bartë, nëse është e dukshme se nuk kanë dhënë kundërkompensim që i përgjigjet vlerës së saj, si dhe nga personat e tretë nëse nuk dëshmojnë se për sendin apo për pasurinë kanë dhënë kundërkompensim që i përgjigjet vlerës së saj.<sup>40</sup>

Fshehja e pasurisë ose deklarimi i rremë, potencialisht vjen si rrjedhojë e veprave penale të kryera gjatë ushtrimit të funksionit publik, si psh: shpërdorimi i detyrës, përfitimi i paligjshëm i interesave, shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike etj. Si rregull, fshehja e pasurisë apo deklarimi i rremë vjen pas kryerjes së një veprimi tjetër (administrativ apo penal) që ka sjellë një përfitim të pa ligjshëm dhe që tentohet të fshihet apo mbulohet në forma të ndryshme nga ana e subjektit deklarues.<sup>41</sup>

Me korrupsion pasiv nënkuptojmë veprim të qëllimshëm i personit zyrtar, i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi, kërkon ose pranon dobi në cilëndo formë, për vete ose për person të tretë, ose pranon premtim për dobi të këtyllë, me qëllim të veprave ose të përmbahet prej veprimit në

---

<sup>40</sup> Neni 359 a, KPM

<sup>41</sup> Fjorida Ballauri (Kallço), Konflikti i interesave në veprat penale të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, Disertacion për mbrojtje e gradës shkencore “DOKTOR”, Tiranë, 2015, faqe 103



pajtim me obligimet e tij ose t'i ushtrojë kompetencat e tij në kundërshtim me obligimet zyrtare.<sup>42</sup>

Ky veprim mund të kryhet me anë të dhurimit të pasurisë personave të tjerë, me anë të huamarrjeve apo huadhënieve fiktive, shitjes së padeklaruar në organet kompetente ose shitjeve fiktive, me anë të kryerjes së veprimeve të tjera financiare ose transaksioneve të copëzuar, apo nëpërmjet shkëmbimit të pasurisë, transferimit të saj, fshehjes apo mbulimit të natyrës së vërtetë të burimit, vendosjes së pronësisë ose të drejtave të tjera pasurore, në emër të një personi tjetër, me qëllim mos lidhjen e pasurisë me pronarin e vërtetë të saj.

Por, kjo vepër penale mund të kryhet dhe me mosveprim duke heshtur dhe mosdeklaruar pasuri apo likuiditete pavarësisht se si dhe ku i mban ato. Një formë tjetër e deklarimit të rremë është rasti kur subjekti deklaron pasuri apo likuiditete që nuk i ka, me synimin për t'i paraprirë pasurimit të tij në të ardhmen.<sup>43</sup>

### **3.6. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare neni 360**

- (1) Ai i cili publikut apo personit të pathirur do të kumtojë, dorëzojë apo në mënyrë tjetër do t'ia bëjë të arritshme të dhënat që paraqesin fshehtësi zyrtare apo grumbullon të dhëna të tilla me qëllim që t'i kumtojë apo dorëzojë publikut apo personit të pathirur, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer nga leverdia apo për shkak të shfrytëzimit të të dhënave jashtë vendit, kryerësi do të dënohet me së paku një vjet burgim.
- (3) Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (4) Për fshehtësi zyrtare llogariten të dhënat apo dokumentet që me ligj, me dispozitë tjetër apo me vendim të organit kompetent të marra në bazë të ligjit janë shpallur për fshehtësi zyrtare dhe zbulimi i së cilëve ka apo mund të ketë pasoja të dëmshme për shërbimin.<sup>44</sup>

---

<sup>42</sup> Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, neni 2. Paragrafi 2, alinea 1

<sup>43</sup> Fjorida Ballauri (Kallço), Konflikti i interesave në veprat penale të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, Disertacion për mbrojtje e gradës shkencore "DOKTOR", Tiranë, 2015, faqe 104

<sup>44</sup> Neni 360, KPM

### **3.7. Keqpërdorimi I fshehtësisë shtetërore, zyrtare apo ushtarake neni 360-a**

- (1) Personi zyrtar i cili do të shfrytëzojë të dhëna që paraqesin fshehtësi shtetërore, zyrtare apo ushtarake me qëllim përfitimi për vete apo për tjetërkënd ndonjë dobi apo shkaktim të dëmit tjetërkujt, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (2) Me dënimin nga paragrafi 1 do të dënohet ai i cili pas pushimit të shërbimit, me qëllim të njejtë do t'i shfrytëzojë të dhënat e tilla apo do t'ia kumtojë, dorëzojë apo bëjë të arritshme tjetërkujt për shfrytëzim.<sup>45</sup>

---

<sup>45</sup> Neni 360 a, KPM

**3.8. Evidenca statistikore për veprat penale marrja dhe dhënia e ryshfetit nga organet e ndjekjes nga viti 2009 deri më 2014.**

**3.9. Të Raportuar dhe të ndjekur penalisht për veprën penale marrja e ryshfetit**

VITI	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej
<b>Jan ëparaqitur</b>	<b>19</b>	<b>4</b>	<b>9</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>11</b>	52
Femra	4	-	2	-	1	1	8
Propozimakuze	17	4	7	3	4	7	42
<b>Jan ëakuzuar</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>7</b>	40
Femra	-	-	-	1	-	-	1
Procedura e nd ërprer ë	-	-	-	-	-	-	
T ë liruar nga akuza	-	-	-	-	-	-	
Akuza e hudhur posht ë	-	-	-	-	-	-	
<b>T ëgjykuar</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>7</b>	40
Femra	-	-	-	1	1	-	2

Nga të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e numrit të vepres penale marrja e ryshfetit, për periudhën 2009-2014 numri i personave të paraqitur në v. 2009-2010-2011 ka qenë më i lartë në krahasim me vitet 2013-2014, ku ka numër të vogël të personave të paraqitur.

Nga pasqyra e këtyre të dhënave vërehet se në periudhën kohore 2009-2014, numri i personave të dënuar për veprën penale marrja e ryshfetit është dukshëm më i vogël se sa ai i të dyshuarve. Numri i përgjithshëm i personave të dënuar për këtë vepër penale në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore në fjalë ishte 57 persona, nga të cilët 11 ishin femra. Rritje të dallueshme në krahasim me vitin 2009-2011-2012 dhe 2013 ka në vitin 2010 ku janë dënuar 13 persona, nga të cilët 3 i përkasin gjinisë femërore, ndërsa më shumë femra ka në vitin 2010 ku prej 8 personave të denuar 4 janë të gjinisë femërore.<sup>46</sup>

<sup>46</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.

### **3.9.1. Të Raportuar dhe të ndjekur penalisht për veprën penale dhënia e ryshfetit**

Nga të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e numrit të veprës penale dhënia e ryshfetit, për periudhën 2009-2014 numri i personave të paraqitur në v. 2009-2010-2011 ka qenë më i lartë në krahasim me vitet 2013-2014, ku ka numër të vogël të personave të paraqitur.

Nga pasqyra e këtyre të dhënave vërehet se në periudhën kohore 2009-2014, numri i personave të dënuar për veprën penale marrja e ryshfetit është dukshëm më i vogël se sa ai i të dyshuarve. Numri i përgjithshëm i personave të dënuar për këtë veprë penale në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore në fjalë është 40 persona, nga të cilët 2 ishin femra.

Rritje të dallueshme në krahasim me vitin 2009-2010-2011, ka në vitin 2012 ku janë dënuar 8 persona, nga të cilët 1 i përket gjinisë femërore. Në krahasim me veprën penale marrja e ryshfetit, të dhënia e ryshfetit kemi numër më të ulët të personave të dënuar si dhe dukshëm numër më të ulët të gjinisë femërore.<sup>47</sup>

#### **3.10. Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale të ryshfetit**

Këtë veprë penale e kryen personi zyrtar që do të kërkojë apo do të pranojë dhuratë apo një dobi tjetër, ose do të pranojë premtim për dhuratë që në suaza të autorizimit të vet të kryejë ndonjë veprim zyrtar që nuk do të guxonte ta kryejë. Pra, kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë personi zyrtar apo personi përgjegjës.<sup>48</sup>

Poashtu, kryerës i kësaj veprë penale janë edhe personat të cilët nga institucionet publike pranojnë shërbime, këta individë me qëllimin që të pranojnë shërbime me cilësore, më të shpejta ose për të pranuar shërbime të cilat sipas dispozitave ligjore nuk kanë të drejtë që të i pranojnë (për të fituar një të drejtë të cilën sipas dispozitave ligjore nuk mund që ta kenë) dhe bëjnë shkelje të dispozitave të Kodit Penal duke u involvuar në vepra penale si: 1. Dhënia e ryshfetit, 2. Dhënia e ryshfetit personit publik të huaj. Pra, ryshfet dhënës mund të jetë çdo person.

---

<sup>47</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.

<sup>48</sup> I.Zejneli, Pjesa e posaçme (cikël leksionesh), Tetovë, 2007, faqe 154

### **3.11. Raporti mes personit zyrtar dhe personit që jep ryshfet**

Elementi që mund të krijojë raportin ose lidhjen mes personit zyrtar dhe personit që jep ryshfet është përfitimi i parregullt, i cili buron nga interesa të ndryshme. Dhënia e ryshfetit zyrtarëve publikë mund të ketë një shumëllojshmëri qëllimesh. Zyrtarët publikë mund të jenë në gjendje të nxjerrin ryshfet për një shërbim publik legjitim, të cilin përndryshe ata mund t'ia mohojnë klientit, ose t'ia vonojnë për një periudhë të pacaktuar. Nga ana tjetër, ryshfeti mund të paguhet edhe me iniciativën e biznesit, me qëllim për të ndikuar ndër të tjera në vendimet rregullative, vlerësimet tatimore, proceset e prokurimeve publike ose sigurimin e shërbimeve publike. Për secilën prej këtyre procedurave, të lidhura me biznesin, qëllimi i ryshfetit mund të ndryshojë sipas natyrës së procesit ose vendimit që është subjekt i manipulimit. Për shembull, ryshfeti mund të synojë të ndryshojë një vendim negativ për një leje ndërtimi dhe në këtë mënyrë lejon finalizimin e një procesi administrativ, në interes të kompanisë.

Ryshfeti është i lidhur më së shpeshti me zyrtarët publikë, të korruptuar, të cilët pranojnë para, dhurata ose favore të tjera, të paligjshme, që lidhen me ofrimin e shërbimeve publike. Por, sidoqoftë, forma të rëndësishme të ryshfetit ndodhin përbrenda vetë sektorit privat, që do të thotë, ndërmjet përfaqësuesve të entiteteve të biznesit të sektorit privat.

Përfitim i ndërsjellë: Kjo zakonisht ndodh në ryshfet me normat e ulëta tatimore. Për shembull, dhënia e ryshfetit për të pranuar prona të nënvlerësuara për regjistrim ose për të zvogëluar normat e tatimit në pronë. Në raste të tilla, si dhuruesi i ryshfetit dhe përfituesi i ryshfetit përfitojnë dhe qeveria vuan. Në mënyrë tipike, për raste të tilla, nuk ka ankues.

### **3.12 Shkaqet dhe arsyt pse bëhet ryshfeti**

Kjo më së shumti ndodh kur shërbimet ndaj publikut vonojnë në kohë, për shërbime ku qytetari duhet të presë në rradhë të gjata për të marrë shërbimin e kërkuar, kur strukturat shtetërore nuk janë eficiente etj. Ky është ai që përgjithësisht quhet “korrupsion i vogël” i praktikuar nga nëpunësit publikë, që mund të paguhet pak dhe varen në “pagesa te vogla” të qytetarëve për të ushqyer familjet dhe për të paguar faturat. Shkaqet dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e këtij korrupsioni janë nga varfëria dhe niveli i ulët i jetesës. Gjithashtu, korrupsioni i një shkalle të tillë është tregues i një kategorie nëpunësish publikë të paguar pak ose keq, të mungesës së strukturave kontrolluese dhe monitoruese si dhe të

mungesës së efektivitetit të sistemeve që ofrojnë shërbim të kualifikuar dhe të shpejtë për qytetarin.

Ky lloj korrupsioni ndikon drejtpërdrejt mbi individin dhe është i prekshëm prej tij çdo ditë duke krijuar në këtë mënyrë dhe perceptimin individual të gjithësecilit mbi nivelin e korrupsionit në një vend.<sup>49</sup>

Korrupsioni i ashtuquajtur "i madh"<sup>50</sup> i nëpunësve të lartë publikë shpesh përfshin rryshfete në vlera shumë të mëdha, të cilat mund të marrin dhe karakter transnacional, qoftë për shkak të aktivitetit që përfshin dy ose më shumë vende, qoftë edhe për shkak të produkteve kriminale të këtij korrupsioni që gjithmonë e më shumë tentohet të transferohet jashtë vendit në llogari bankare "të pakontrollueshme".

Ky lloj korrupsioni mund të shfaqet sa herë një zyrtar publik ka fuqi apo ndikim mbi një individ apo të ardhura të një firme private, nëpërmjet formalizimit në nxjerrjen e një akti nënligjor, dhënies së informacionit të klasifikuar ose paraprakisht (duke cënuar barazinë e konkurentëve), miratimit të projekteve të ndryshme etj. Ndërkohë fushat më vulnerabël nga ky korrupsion janë pasuria publike, fondet publike dhe koncensionet.<sup>51</sup>

Ryshfeti i zyrtarëve publikë mund të ketë një shumëllojshmëri qëllimesh. Zyrtarët publikë mund të jenë në gjendje për të nxjerrë ryshfet për një shërbim publik legjitim që ata mund t'ia mohojnë klientit ose të vonojnë shërbimin për një periudhë të pacaktuar. Qëllimi i ryshfetit mund të ndryshojë sipas natyrës së procesit ose vendimit që është subjekt i manipulimit. Për shembull, ryshfeti mund të synojë të ndryshojë një vendim negativ për leje ndërtimi dhe në këtë mënyrë lejon finalizimin e një procesi administrativ në interes të kompanisë së caktuar.

Në vijim do të theksoj disa nga arsyet që shpiejnë në dhënien e ryshfetit:

1. Nevoja për shpejtësi: Kjo rezulton në pagesën e parave me qëllim që të përshpejtohet procedura e shërbimit. Kjo nga ana tjetër stimulon zyrtarët për të ngadalësuar procedurat me qëllim, në mënyrë që ata të kenë përfitime.

---

<sup>49</sup> Fjorida Ballauri (Kallço), Konflikti i interesave në veprat penale të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, Disertacion për mbrojtje e gradës shkencore "DOKTOR", Tiranë, 2015, faqe 113

<sup>50</sup> Termi "korrupsion i madh" është përmendur sipas të njëjtit koncept të trajtuar në botimin e George Moody Stuart, Korrupsioni i madh në zhvillimin e Botës së Tretë, 1997.

<sup>51</sup> Fjorida Ballauri (Kallço), Konflikti i interesave në veprat penale të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, Disertacion për mbrojtje e gradës shkencore "DOKTOR", Tiranë, 2015, faqe 113

2. Komoditet/ lehtësim: Njerëzit paguajnë për shkak se ata janë shumë të zënë për të shkuar në një zyrë dhe për të gjetur të përshtatshme për të korruptuar ndonjë zyrtar për një pagesë të përgjithshëm të shërbimit. Kjo ndodh në rastet kur proceset janë të ndërlikuara, dhe të gjata.
3. Frika, nervozizmi dhe lehtësimi: Shumë njerëz bëjnë panik të shkojnë në zyrat shtetërore dhe frikësohen se do të dëmtohen nëse nuk paguajnë ryshfet. Në shumë raste, frika është krejtësisht e pajustificuar, por ende fatkeqësisht vazhdon. Njerëzit gjithashtu paguajnë ryshfet nga lehtësimi. Ata e konsiderojnë ryshfetin si një bakshish të paguar nga satisfaksioni dhe lehtësimi në përfundimin e shërbimit.
4. Keqinformimi nga ndërmjetësues të caktuar- e kjo është e lidhur ngushtë edhe me injorancën dhe mungesën e vullnetit për të mësuar. Njerëzit injorantë janë të rrezikuar nga mashtrimi prej zyrtarëve të korruptuar që i hutojnë ata dhe në këtë mënyrë ata bien pre e zyrtarëve dhe kryejnë ryshfet.
5. Bindje nga ana e shoqërisë dhe të moshuarit: Dhënia e ryshfetit dhe ideja që nëse një individ nuk paguan fare ryshfet nuk mund të arrijë qëllimin, është kaluar nga brezi në brez dhe është fortifikuar nëpërmjet diskutimeve në shoqëri.
6. Frika nga dënimi justifikuar- Kjo përfshin pagesa të tilla si dhënia e ryshfeteve në polici për të kërkuar rrugë të tjera kur ka shkelje të qartë ligjore. Në mungesë të ryshfetit, ryshfet dhënësi është i pambrojtur ndaj dënimit.
7. Shmangia e humbjes së biznesit: Ky është një arsytim i fortë për dhënien e ryshfetit në sektorin privat. Bizneset nuk e kanë proplem për të dhënë ryshfet për shkak të dy arsyeve. Së pari, në qoftë se ata nuk japin ryshfet, ata vuajnë humbje të biznesit. Së dyti, çdo gjë që ata të paguajnë mund të kalojë tek konsumatori nëpërmjet një çmimi të zgjeruar të shitjes.<sup>52</sup>

---

<sup>52</sup>T R Raghunandan, 08 Jan 2014 , Citizen Matters.

### **3.13 Profili i kryerësve të veprës penale marrja dhe dhenia e ryshfetit**

#### **3.13.1 Moshë, gjinia dhe përkatësia etnike**

Nga karakteristikat që e përcaktojnë profilin e kryerësve të veprave penale kundër detyrës zyrtare përfshihen pyetje si moshë, gjinia dhe përkatësia etnike, si dhe arsimimi i tyre.

Në aspektin e strukturës së moshës të përfaqësuar janë grupmoshat prej 18 vjet e deri 60 vjet e sipër.

Sipas gjinisë, numri shumë më i madh i të akuzuarve janë meshkuj, ndërsa numër më i vogël i të akuzuarve janë të gjinisë femërore.

Lidhur me pyetjen për moshën, nga praktika vërehet se kryerësit më të shpeshtë janë të moshës 30 deri në 59 vjet që kanë pozita dhe kompetenca të larta në organin ku punojnë. Edhe pse janë të përfaqësuar gati të gjithë grupmoshat, prapëseprap në përqindje më të madhe si kryerës të veprave penale korruptuese paraqiten personat të cilat i takojnë grupmoshës 45 deri 55 vjet dhe prej 36 deri 45 vjet. Më e vogël është pjesëmarrja e grupmoshës prej 18 deri 25 vjet dhe të asaj mbi 60 vjet.

Në bazë të të dhënave statistikore rezulton se pjesa më e madhe e kryerësve të veprave penale kundër detyrës zyrtare për nga përkatësia etnike janë maqedonas, gjithsej 745 persona. Pjesëmarrja e personave me përkatësi shqiptare për nga numri i periudhës kohore në fjalë gjithsej janë 118 persona, përderisa pjesëmarrja e personave me përkatësi kombëtare romë ose kombësi tjetër është me numër të ulët.<sup>53</sup>

#### **3.13.2 Shkalla e arsimimit të kryerësve**

Evidencat statistikore tregojnë se përqindja më e madhe e kryerësve janë me fakultet por i madh është edhe numri i atyre kryerësve të cilët janë me shkollim të mesëm. Si kryerës të veprave penale kundër detyrës zyrtare, më rrallë paraqiten persona me shkollë të lartë dhe arsim fillor.

---

<sup>53</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.




### 3.14 Organet në të cilat kryhet rryshfeti

Sipas të dhënave të hulumtimit rezulton se kryerja e rryshfetit është e përfaqësuar në të gjitha fushat e shoqërisë, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. Kepërdorimi pozitës bëhet kryesisht nga menaxherët dhe punonjësit e ndërmarrjeve publike (55%), pastaj në ministrinë, komuna, gjykata, arsim dhe autoritetet e tjera qeveritare (16%), dhe në shoqëri aksionare (10%). Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në organet e administratës shtetërore, në gjykatat dhe organet dhe organizatat e tjera që kryejnë punë të caktuara profesionale, administrative dhe punë të tjera në suazat e të drejtave dhe obligimeve të Republikës së Maqedonisë, në komunat dhe në Qytetin e Shkupit, si dhe personat e tjerë që kryejnë autorizime publike.

### 3.15 Sanksionet me të cilat janë denuar kryerësit e veprës penale marrja dhe dhënia e rryshfetit prej vitit 2009 deri më 2014


Nga të dhenat statistikore për sanksionet që u janë shqiptuar kryerësve të veprës penale marrja dhe dhënia e rryshfetit gjatë periudhës 2009-2014, rezulton si vijon:

#### Sanksionet e shqiptuara për veprën penale marrja e rryshfetit në v. 2009




Në vitin 2009 gjithsej janë shqiptuar 8 denime dhe të gjithë kryerësit kanë qenë të gjinisë mashkullore. Denime kryesore u janë shqiptuar 5 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg.

Denime sekondare u janë shqiptuar 2 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me ndalim ushtrimi të profesionit. Masa alternative, burg, është shqiptuar për një kryerës, si dhe marrja e sendeve si masë e sigurisë është shqiptuar ndaj 1 kryerësi.




Në vitin 2009 për veprën penale dhënia e ryshfetit gjithsej janë shqiptuar 6 denime, dhe të gjithë kryerësit kanë qenë meshkuj. Me burg si denim kryesor është denuar një kryerës. Denim sekondar u është shqiptuar 2 kryerësve, gjegjësisht me dëbim të huajit. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 3 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 2 persona.

## Sanksionet e shqiptuara per vepren penale marrja e rryshfetit në v. 2010




Në vitin 2010 për veprën penale marrja e rryshfetit gjithsej janë shqiptuar 13 denime, prej të cilëve 10 kanë qenë meshkuj dhe 3 femra. Me denime kryesore janë denuar 8 kryerës, prej të cilëve 7 kryerës me burg ndersa 1 kryerës me gjobë. Masat alternative janë shqiptuar ndaj 5 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 4 persona.




Në vitin 2010 për veprën penale dhënia e ryshfetit gjithsej janë shqiptuar 7 denime, dhe të gjithë kryerësit kanë qenë meshkuj. Me burg si denim kryesor janë denuar 2 kryerës. Denim sekondar u është shqiptuar 2 kryeresve, gjegjësisht me dëbim të të huajit. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 3 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 4 persona.

### Sanksionet e shqiptuara për veprën penale marrja e ryshfetit në v. 2011




Në vitin 2011 për veprën penale marrja e ryshfetit gjithsej janë shqiptuar 8 denime, prej të cilëve 4 kryerës kanë qenë meshkuj dhe 4 femra. Me burg si denim kryesor janë denuar 3 kryerës. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 5 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 3 persona.

## Sanksionet e shqiptuara për veprën penale dhënia e ryshfetit në v. 2011




Në vitin 2011 për veprën penale dhënia e ryshfetit gjithsej janë shqiptuar 7 denime, dhe të gjithë kryerësit kanë qenë meshkuj. Me burg si denim kryesor janë denuar 3 kryerës. Denim sekondar u është shqiptuar 1 kryerësi, gjegjësisht me dëbim të të huajit. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 3 kryerësve, gjegjësisht janë dënuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 4 persona.

## Sanksionet e shqiptuara për veprën penale marrja e rryshfetit në v. 2012




Në vitin 2012 për veprën penale marrja e rryshfetit gjithsej janë shqiptuar 9 denime, prej të cilëve 8 kanë qenë meshkuj dhe 1 femër. Me burg si denim kryesor janë denuar 6 kryerës. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 3 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 5 kryerës.

## Sanksionet e shqiptuara për veprën penale dhënia e rryshfetit në v. 2012




Ne vitin 2012 per vepren penale dhenia e ryshfetit gjithsej jane shqiptuar 8 denime, prej te cileve 7 kane qene meshkuj dhe 1 femer. Me burg si denim kryesor jane denuar 3 kryeres. Masa alternative jane shqiptuar ndaj 5 kryeresve, gjegjesisht jane denuar me burg, si dhe me marrje te sendeve si mase e sigurise jane denuar 4 kryeres.

### Sanksionet e shqiptuara per vepren penale marrja e ryshfetit në v. 2013




Ne vitin 2013 per vepren penale marrja e ryshfetit gjithsej jane shqiptuar 9 denime, prej te cileve 8 kane qene meshkuj dhe 1 femer. Me burg si denim kryesor jane denuar 7 kryeres. Masa alternative jane shqiptuar ndaj 2 kryeresve, gjegjesisht jane denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 2 kryerës.

## Sanksionet e shqiptuara per vepren penale dhenia e rryshfetit në v. 2013



Në vitin 2013 për veprën penale dhënia e rryshfetit gjithsej janë shqiptuar 5 denime, dhe të gjithë kryerësit kanë qenë meshkuj. Me burg si denim kryesor janë denuar 3 kryerës. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 2 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 3 kryerës.


## Sanksionet e shqiptuara per vepren penale marrja e rryshfetit në v. 2014





Në vitin 2014 për veprën penale marrja e ryshfetit gjithsej janë shqiptuar 10 denime, prej të cilëve 8 kanë qenë meshkuj dhe 2 femra. Me burg si denim kryesor janë denuar 6 kryerës. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 4 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 6 kryerës.

### Sanksionet e shqiptuara për veprën penale dhënia e ryshfetit në v. 2014



Në vitin 2014 për veprën penale dhënia e ryshfetit gjithsej janë shqiptuar 7 denime, dhe të gjithë kryerësit kanë qenë meshkuj. Me burg si denim kryesor janë denuar 2 kryerës. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 5 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg, si dhe me marrje të sendeve si masë e sigurisë janë denuar 4 kryerës.

## KAPITULLI I KATËRT

### FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE ZYRTARE

Për shkak të vetë natyrës së larmishme të marrëdhënieve shoqërore, të stadit të zhvillimit të shoqërisë sonë dhe të frekuencës së raporteve qytetarë-organe shtetërore, apo raporteve private (mes vetë qytetarëve), veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe ato të mashtrimit kanë patur një përhapje relativisht të gjerë.<sup>54</sup>

#### 4.1 Nocioni i veprës penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare

Çfarë përbën dokument sipas nenit 361 të K. Penal?

Neni 361 i Kodit penal, jep vetëm emërtimin e veprës penale, por nuk i përcakton elementët përbërës të saj. Ky nen parashikon se:

- (1) Personi zyrtar i cili në dokumentin, librin, shkresën zyrtare do të fut të dhëna të pavërteta apo nuk do të fut ndonjë të dhënë e rëndësishme apo me nënshkrimin e vet, përkatësisht me vulën zyrtare do të vërtetojë dokument, libër apo shkresë zyrtare me përmbajtje të pavërtetë ose me nënshkrimin e vet, përkatësisht me vulën zyrtare do të mundësojë përpilimin e dokumentit, librit apo shkresës zyrtare me përmbajtje të pavërtetë, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (2) Me dënim nga paragrafi 1 do të dënohet edhe personi zyrtar i cili dokumentet nga ai paragraf do t'i përdor në shërbim sikur të jenë të vërteta apo do t'i asgjësojë, fshehë apo do t'i dëmtojë në masë të madhe apo në mënyrë tjetër do t'i bëjë të papërdorshme.
- (3) Personi përgjegjës në personin juridik i cili zotëron pasuri shtetërore apo shoqërore, i cili do t'i kryejë veprat nga paragrafët 1 dhe 2, do të dënohet me dënimin e caktuar për ato vepra.<sup>55</sup>

”Duke qenë se dispozitivi i kësaj norme penale është i thjeshtë, trajtimi i elementëve përbërës të saj bëhet nga doktrina dhe jurisprudenca gjyqësore. Sipas autorit Ismet Elezi<sup>56</sup>: “Me falsifikim të dokumenteve kuptojmë paraqitjen në të, të rrethanave të rreme, ose përpilimin e një dokumenti krejtësisht të falsifikuar, si dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuar.

---

<sup>54</sup> Aleks Nikolli, disa probleme teorike dhe praktike rreth veprave penale të falsifikimit të dokumentev dhe të mashtrimit, magjistrat, Universiteti i Shkodrës, viti 2014, faqe 1

<sup>55</sup> K. penal neni 361

<sup>56</sup> I.Elezi, E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme 1, Tiranë 1999, faqe 193.

Me këtë shtrohet pyetja se çfarë duhet të konsiderohet “dokument”?

Dokument është secili send që është i përshtatshëm apo i caktuar të shërbejë si provë për ndonjë fakt që ka vlerë për marrëdhëniet juridike. Dokument publik është dokumenti i lëshuar nga organi kompetent, organizata apo personi që ushtron punë me interes public në bazë të ligjit apo dispozite tjetër e bazuar në ligj.<sup>57</sup>

Sipas fjalorit të sotëm të gjuhës shqipe dokument do të thotë:

1. shkresë zyrtare që dëshmon ose që vërteton diçka; akt i shkruar me ato që janë thënë e që janë vendosur në një mbledhje, në një gjyq etj.; shënim i mbajtur sipas rregullave të caktuara; diçka e shkruar a e vizatuar, që ka vlerë si dëshmi historike: dokument i rëndësishëm (sekret); dokumente arkivore. 2. librezë ose fletë e posaçme që i jepet dikujt nga organet shtetërore a nga një organizatë për të vërtetuar anëtarësinë ose kush është ai: i pajisur me dokument.<sup>58</sup>

Sipas Black law dictionary termi dokument do të thotë:

“1. Diçka e prekshme në të cilën fjalët, simbolet, ose shenjat regjistrohen.

1. veprat, marrëveshjet, shkresat e letrat e titujve të të drejtave, letra, fatura, dhe instrumente të tjera të shkruara që përdoren për të provuar një fakt.”<sup>59</sup>

Sipas, Prof. Shasivari, dokumentet kanë kuptimin e gjerë dhe të ngushtë. Në kuptimin e gjerë me dokument nënkuptohet çdo objekt (monumentum) që ka shenjë të dukshme me të cilën mund të provohet ndonjë ngjarje, rrethanë ose fakt (për shembull: shenjat kufitare). Ndërsa, në kuptimin e ngushtë me dokument nënkuptohet shkresa zyrtare (documentum) e cila lëshohet me qëllim që me të, të vërtetohet ekzistimi ose mosekzistimi i ndonjë ngjarjeje, rrethane ose fakti (për shembull: certifikata e shtetësisë). Sipas asaj se kush i lëshon dokumentet (në kuptimin e ngushtë), ato ndahen në: dokumente publike dhe dokumente private. Dokumentet publike janë shkresat të cilat në formë të rregullt i ka lëshuar organi shtetëror në kuadër të kompetencës së vet ose personi juridik në punët që i kryen mbi bazën e autorizimeve publike, me të cilat provohet ajo që zyrtarisht vërtetohet ose caktohet në të, si për shembull: diplomat, letërnjoftimet, pasaportat, vendimet, aktgjykimet, lejet, procesverbalet, etj. Dokumentet private janë shkresat që i lëshojnë personat privat juridik ose

---

<sup>57</sup> K.Penal i RM-së, neni 122, paragrafi 11

<sup>58</sup> [www.fjalorthi.com](http://www.fjalorthi.com)

<sup>59</sup> Bryan A. Garner, Black law dictionary, 9-th edition, WEST PUBLISHING CO, 2009, faqe 555.

fizik dhe me to provohet se deklarata në të rrjedh nga dhënësi i tyre, si për shembull: testamenti, kambiali, kontratat, librat afariste, autorizimet, etj<sup>60</sup>.

Përfitimi që mund të vijë nga përdorimi i një dokumenti të falsifikuar, është një pasojë sekondare dhe jo e domosdoshme e kësaj figure krimi, pasi ajo nuk vjen në çdo rast dhe nga ana tjetër, mosardhja e saj nuk përbën shkak që vepra penale e falsifikimit të dokumenteve të ngelë në tentativë. Momenti i konsumimit të veprës penale të përdorimit të dokumentit të falsifikuar, është moment që autori ia paraqet ato autorit përkatës shtetëror, apo privat, dhe jo momente të tjera të mëvonshme.

Ekzistojnë tri veprime të ndryshme të kryerjes se kësaj vepre penale:

- Përfshirja e të dhënave të pasakta ose mungesa e disa të dhënave të rëndësishme – informata që janë të rëndësishme për marrëdhëniet juridike ose për kryeresin e caktuar në këto dokumente
- verifikimi nënshkrimit dhe vulës zyrtare të dokumenteve të përmendura,
- nënshkrimin ose vulën zyrtare që japin mundësinë për dokumentet të jenë ligjore.

Objekti i veprimit është një dokument zyrtar, dokument biznesi, libër ose akt. Ekzekutori është një person zyrtar ose përgjegjës në institucionet RMsë, i cili vepron me qëllim.

Falsifikimi i dokumenteve "është një lloj i krimit të jakës së bardhë. Ai përfshin tjetërsimin, ndryshimin ose modifikimin e një dokumenti me qëllim të mashtrimit të një personi tjetër. Mund të përfshijë edhe kalimin e kopjeve të dokumenteve që njihen si të rreme. Në shumë shtete falsifikimi i një dokumenti është një krim i dënueshëm.

Kodi penal i RM-së parashikon kre të veçantë për veprat penale kundër qarkullimit juridik, ku ngërthehet si vepër penale falsifikimi i dokumenteve, neni 378 sipas të cilit:

- (1) Ai i cili do të përpilojë dokument të rrëjshëm apo do të përmisojë dokument me qëllim që dokumenti i tillë të përdoret si i vërtetë apo i cili dokumentin e rrejshëm apo i përmirësueshëm do ta përdorë si të vërtetë, do të dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre vjet.
- (2) Tentimi është i dënueshëm.

---

<sup>60</sup> Për më tepër shih në: Shasivari, Dr., Jeton, E drejta administrative, Shkup, 2015, fq. 242.

- (3) Nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, çekun, librin public apo zyrtar apo librin tjetër që duhet të mbahet në bazë të ligjit, kryerësi do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (4) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë.<sup>61</sup>
- Ndërsa, raste të veçanta të falsifikimit të dokumenteve llogaritet se ka kryer vepër të falsifikimit të dokumentit:
- (1) Ai i cili, ndonjë letër, formular apo ndonjë send tjetër në të cilën ndonjë person e ka vënë nënshkrimin e vet pa autorizim do ta plotësojë me deklaratë që është me rëndësi për marrëdhëniet juridike,
- (2) Ai i cili do të mashtrojë tjetërkënd për përmbajtjen e dokumentit që ta vë nënshkrimin e vet në të, duke vlerësuar se nënshkruan nën një dokument tjetër ose nën përmbajtje tjetër,
- (3) Ai i cili do të japë dokument në emër të ndonjë personi pa autorizimin e tij ose në emër të ndonjë personi që nuk ekziston,
- (4) Ai i cili si botues i dokumentit pranë nënshkrimit të tij do të shtojë se ka ndonjë pozitë, titull apo gradë edhe pse nuk ka pozitë, titull apo gradë të tillë, por kjo ka ndikim qenësor ndaj fuqisë provuese të dokumentit, dhe
- (5) Ai i cili do të përpilojë dokument ashtu që pa autorizim do të përdorë vulë ose shenjë të vërtetë.
- (6) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me denim me gjobë.<sup>62</sup>

Disa lloje të dokumenteve që zakonisht falsifikohen janë:

- Deklaratat tatimore dhe pasqyrat e të ardhurave
- Kontrolllet personale
- Të dhënat e llogarisë bankare
- Librat e mbajtjes së regjistrave të biznesit
- Dokumentet e emigracionit (të tilla si viza, pasaporta, etj)
- Kartat e identifikimit dhe çertifikatat e lindjes.

---

<sup>61</sup> K. Penal, neni 378

<sup>62</sup> K. Penal, neni 379

Ai i cili si dëshmi në qarkullim juridik do të përdorë dokument, libër apo shkresë për të cilët e di se janë të pavërteta, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.<sup>63</sup>

#### **4.2 Arkëtimi dhe pagesa kundërligjore**

Personi zyrtar ose personi përgjegjës në personin juridik i cili zotëron pasuri shtetërore ose shoqërore i cili prej dikujt do të arkëtojë shumë që ai nuk është i detyruar të paguajë apo do t'i arkëtojë më tepër se sa është i detyruar të paguajë apo i cili gjatë pagesës apo dorëzimit të sendeve do të paguajë apo do të dorëzojë më pak se sa ka qenë i detyruar, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.<sup>64</sup>

Transaksionet financiare shpesh i drejtohen flukseve të paligjshme dhe private nëpërmjet pagesave të paligjshme dhe pagesave nga rruga e tyre ligjore. Aktet e tilla përfaqësohen më së shumti në procedurën e prokurimit publik. Sipas përshkrimit të personit të tij juridik, akti merret nga personi zyrtar ose përgjegjës në institucionet e RMsë, i cili grumbullon diçka nga e cila nuk është e detyruar të paguajë ose mbledhë më shumë se sa është i detyruar të paguajë ose që, gjatë pagesës ose dorëzimit të disa gjërave. Puna manifestohet në dy forma:

- Mbledhja e paligjshme
- Pagesa e paligjshme

---

<sup>63</sup> K. Penal neni 380, paragrafi 1.

<sup>64</sup> K. Penal, neni 362

**4.3 Evidenca statistikore për veprat penale falsifikimi i dokumenteve nga organet e ndjekjes nga viti 2009 deri më 2014.**

**4.4 Të Raportuar dhe të ndjekur penalisht për veprën penale falsifikimi i dokumenteve**

VITI	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej
<b>Jan ë paraqitur</b>	<b>18</b>	<b>35</b>	<b>46</b>	<b>32</b>	<b>39</b>	<b>22</b>	<b>192</b>
Femra	5	9	15	6	9	7	51
Propozimakuze	3	13	12	7	18	8	61
<b>Jan ë akuzuar</b>	<b>16</b>	<b>9</b>	<b>23</b>	<b>12</b>	<b>5</b>	<b>16</b>	<b>81</b>
Femra	1	1	5	7	-	6	20
Procedura e ndërprerë	4	1	4	1	-	4	14
Të liruar nga akuza	1	-	7	2	2	-	12
Akuza e hudhur poshtë	1	5	1	-	-	3	10
<b>Të gjykuar</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>11</b>	<b>9</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>45</b>
Femra	1	1	2	5	-	3	12

Nga të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e numrit të veprës penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare të kryer për periudhën 2009-2014 numri i personave të paraqitur në vitin 2009 ka qenë më i ulët në krahasim me v. 2010-2014 ku dukshëm ka numer më të lartë të personave të paraqitur. Nga pasqyra e këtyre të dhënave në periudhën kohore 2009-2014, numri i personave të dënuar është dukshëm më i vogël se sa ai i të dyshuarve. Numri i përgjithshëm i personave të dënuar për këtë vepër penale në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore në fjalë ishte 45 persona, nga të cilët 12 ishin femra.

#### 4.5 Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e këtyre veprave penale

Ekzekutuesi është një person zyrtar ose përgjegjës i cili vepron me qëllim; nuk ka vepër penale nëse personi në punën e tij / saj është e gabuar, kështu që ai mbledh ose paguan më shumë dhe në këtë mënyrë shkel një të drejtë të caktuar. Është e parëndësishme nëse personi në favor të të cilit është paguar një shumë më e madhe është në dijeni të ekzistencës së atij veprimi, apo ka vepruar qëllimisht për të siguruar përfitim material më të madh.

Nga vet fakti që veprat penale kundër detyrës zyrtare, ndahen në vepra penale të cilat mund të kryhen vetëm nga personat zyrtar dhe veprat penale të cilat mund t'i kryejnë edhe personat të cilët nuk e kanë cilësinë e personit zyrtar apo personit përgjegjës, pra është personi zyrtar dhe cdo person tjetër fizik, i cili është subjekt pasiv në kryerjen e veprës penale me të cilin i është dëmtuar ose rrezikuar të drejtat dhe interesat e tij. Kryerës të këtyre veprave penale në radhë të parë janë personat zyrtar dhe personat përgjegjës që ushtrojnë një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve në organe shtetërore.

Punonjësit shtetërore ose në shërbim publik, të cilët gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, të ndikuar nga interesat private, mund të veprojnë në kundërshtim me ligjin, duke shkaktuar pasoja për individët, shoqëritë tregtare dhe për shtetin në tërësi.

#### 4.6 Raporti mes kryerësit dhe veprës penale

Pasi që kryerës i veprës penale kundër detyrës zyrtare është personi zyrtar, raporti me veprën penale zyrtare është shumë i ngushtë pasi që rrjedh nga vetë ai, nga vetë pozita zyrtare që ka, autorizimeve dhe pozicioneve të ndryshme brenda institucioneve shtetërore, varësisht nga hierarkia institucionale brenda institucionit. *Pra, kërkohet lidhja midis veprës penale të kryer dhe ushtrimit të detyrës zyrtare, funksionit menaxhues ose administrativ. Duhet që vepra të jetë kryer gjatë ushtrimit të profesionit apo veprimtarive dhe që kryerësi këto veprimtari t'i ketë shfrytëzuar si mjet apo si rrethanë për kryerjen e veprës penale.*<sup>65</sup>

Kryerësit janë kryesisht persona të strukturës së lartë shoqërore duke u zgjedhur si më profesionistët, me integritet moral dhe profesional, të shkolluar dhe edukuar. Personat të

---

<sup>65</sup> I. Salihu, E drejta Penale, Prishtinë, 2005, fq.493



shtresave të larta janë të kyçur në të gjitha segmentet e pushtetit politik, ekonomik, financiar, gjyqësor dhe segmente tjera. Këta persona të cilët kanë autoritet për të ushtruar nga pozitat e larta shtetërore dhe duke e keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare kryejnë vepra penale duke u involvuar në kriminalitet, persona të tillë quhen kriminel të jakës së bardhë me status të lartë shtetëror. Kryerës të këtyre veprave penale në radhë të parë janë personat zyrtar dhe personat përgjegjës që ushtrojnë një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve në organe shtetërore. Ata janë përfaqësues të shtresave më të larta shtetërore, ata janë persona në pozita dhe me autoritet, titullarë funksionesh të larta shtetërore dhe ekonomike me autorizime të caktuara, persona në vende përgjegjëse, në afarizmin komercial, ekonomik dhe doganor; në qarkullimin e mallrave - agjentë tregtarë të cilët i shfrytëzojnë këto lidhje për qellime kriminale.

Personat zyrtarë që paraqiten si njerëz autoritativ, përfaqësues të qarqeve të larta e të respektuar, me autorizime të mëdha kanë raporte me kriminelë të ndryshëm në atë se u ndihmojnë, i furnizojnë me të dhëna të ndryshme të cilat janë me rëndësi për kryerjen e aktivitetit të tyre kriminal.

Individët e tillë, delikuentët i mbrojnë nga zbulimi dhe ndjekja e policisë, i lirojnë nga aktakuzat, i shpëtojnë nga gjykimi ose u ndihmojnë që të dalin para kohe nga vuajtja e denimit.

Veprat penale të përmendura më lartë mund të konsumohen vetëm gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe jashtë kësaj, këto vepra penale nuk ekzistojnë. Prandaj, vetë pozita e zyrtarëve e ndihmon raportin e kryerësit me veprën penale kundër detyrës zyrtare.

#### **4.7 Arsyet për falsifikimin e dokumenteve zyrtare**

Në thelb, çdo formë e dokumentit zyrtar mund të modifikohet ilegalisht. Falsifikimi i dokumenteve zakonisht bëhet në lidhje me qëllime më të gjera kriminale, të tilla si evazioni fiskal.

Për të qenë i dënuar për falsifikim të dokumenteve, personi i akuzuar duhet të ketë vepruar me qëllim kriminal.

Cilat lloje të akteve mund të përbëjnë falsifikimin e një dokumenti?

Shumë lloje të akteve të ndryshme mund të konsiderohen si falsifikim të një dokumenti, duke përfshirë:

- Ndryshimi ose keqpërdorimi i informacionit faktik siç janë çmimet apo shumat monetare
- Vendosja e informacionit të rremë kur kërkohet për të dhënë deklarata të vërteta
- Falsifikimi i një nënshkrimi
- Mbulimi i pasurisë ose i pronës (sidomos në procedurat e falimentimit)
- Përdorimi me dashje ose shpërndarja e një dokumenti të rremë
- Shkatërrimi i materialit informativ në një hetim

Përsëri, një person mund të mbahet përgjegjës penalisht vetëm nëse vepron me qëllim të mashtrimit ose mashtrimit të një pale tjetër, siç është personi tjetër ose banka. Pra, nëse një person po e përdorte një dokument, por nuk e dinte se ishte i rremë, zakonisht nuk mund të shpallet fajtor për falsifikim të një dokumenti.<sup>66</sup>

#### **4.8 Profili i kryerësve të veprës penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare**

##### **4.8.1 Moshë dhe gjinia e kryerësve të këtyre veprave penale**

Nga karakteristikat që e përcaktojnë profilin e kryerësve të veprave penale kundër detyrës zyrtare përfshihen pyetje si moshë, gjinia dhe perkatsia etnike, si dhe arsimimi i tyre.

Në aspektin e strukturës së moshës të përfaqësuar janë grupmoshat prej 18 vjet e deri 60 vjet e sipër.

Sipas gjinisë, numri shumë më i madh i të akuzuarve janë meshkuj, ndërsa numër më i vogël i të akuzuarve janë të gjinisë femerore.

Lidhur me pyetjen për moshën, nga praktika vërehet se kryerësit më të shpeshtë janë të moshës 30 deri në 59 vjet që kanë pozita dhe kompetenca të larta në organin ku punojnë. Edhe pse janë të përfaqësuar gati të gjithë grupmoshat, prapëseprap në përqindje më të madhe si kryerës të veprave penale korruptuese paraqiten personat të cilat i takojnë grupmoshës 45 deri 55 vjet dhe prej 36 deri 45 vjet. Më e vogël është pjesëmarrja e grupmoshës prej 18 deri 25 vjet dhe të asaj mbi 60 vjet.

---

<sup>66</sup> <http://www.legalmatch.com/law-library/article/falsifying-documents.html>.

#### **4.8.2 Shkalla e arsimimit**

Evidencat statistikore tregojnë se përqindja më e madhe e kryerësve janë me fakultet por i madh është edhe numri i atyre kryerësve të cilët janë me shkollim të mesëm. Si kryerës të veprave penale kundër detyrës zyrtare, më rrallë paraqiten persona me shkollë të lartë dhe arsim fillor.


#### **4.9 Organet në të cilat kryhet vepra penale e falsifikimit dhe arkëtimi kundërligjor**

Sipas të dhënave të hulumtimit rezulton se këto vepra janë të përfaqësuara në të gjitha fushat e shoqërisë, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. Bëhet kryesisht nga menaxherët dhe punonjësit e ndërmarrjeve publike (55%), pastaj në ministritë, komuna, gjykata, arsim dhe autoritetet e tjera qeveritare (16%), dhe në shoqëri aksionare (10%). Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në organet e administratës shtetërore, në gjykatat dhe organet dhe organizatat e tjera që kryejnë punë të caktuara profesionale, administrative dhe punë të tjera në suazat e të drejtave dhe obligimeve të Republikës së Maqedonisë, në komunat dhe në Qytetin e Shkupit, si dhe personat e tjerë që kryejnë autorizime publike.

#### **4.10 Sanksionet me të cilat janë denuar kryerësit e vepres penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare prej vitit 2009 deri me 2014**


Nga të dhenat statistikore për sanksionet që u janë shqiptuar kryerësve të veprës penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare gjatë periudhës 2009-2014, rezulton si vijon:

#### **Sanksionet e shqiptuara per vepren penale falsifikimi I dokumenteve zyrtare në v. 2009**




Në vitin 2009 për veprën penale klasifikimi i dokumenteve zyrtare janë shqiptuar gjithsej 10, ku kryerës kanë qenë 9 meshkuj dhe 1 femër. Me burg si denim kryesor janë denuar 4 kryerës. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 6 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg.

### Sanksionet e shqiptuara për veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare në v. 2010




Në vitin 2010 për veprën penale klasifikimi i dokumenteve zyrtare janë shqiptuar gjithsej 3 denime, ku kryerës kanë qenë 2 meshkuj dhe 1 femër. Me burg si masë alternative janë denuar gjithsej 3 kryerësit.

### Sanksionet e shqiptuara për veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare në v. 2011




Në vitin 2011 për veprën penale klasifikimi i dokumenteve zyrtare janë shqiptuar gjithsej 11 denime, ku kryerës kanë qenë 9 meshkuj dhe 2 femra. Me burg si masë alternative janë denuar gjithsej 11 kryerësit.

## Sanksionet e shqiptuara për veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare në v. 2012




Në vitin 2012 për veprën penale klasifikimi i dokumenteve zyrtare janë shqiptuar gjithsej 9, ku kryerës kanë qenë 4 meshkuj dhe 5 femra. Me burg si denim kryesor janë denuar 2 kryerës. Masa alternative janë shqiptuar ndaj 7 kryerësve, gjegjësisht janë denuar me burg.

## Sanksionet e shqiptuara për veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare në v. 2013



Në vitin 2013 për veprën penale klasifikimi i dokumenteve zyrtare janë shqiptuar gjithsej 3 denime, ku të gjithë kryerësit kanë qenë meshkuj. Me burg si masë alternative janë denuar gjithsej 3 kryerësit.

## Sanksionet e shqiptuara për vepren penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare në v. 2014



Në vitin 2014 për vepren penale klasifikimi i dokumenteve zyrtare janë shqiptuar gjithsej 9 denime, ku 6 kryers këane qenë meshkuj dhe 3 femra. Me denim kryesor është denuar 1 kryerës, edhe atë me burg, ndërsa me burg si masë alternative janë denuar 8 kryerës.<sup>67</sup>

<sup>67</sup> Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.

## PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Krimi kundër detyrës zyrtare është një sjellje negative sociale që si fenomen, nuk është një mbetje e së kaluarës, por fatkeqësisht, është gjithashtu karakteristikë reale e shoqërisë sonë. Ky punim shkencor, konstaton se, ky lloj kriminaliteti paraqitet çdoherë kur detyra zyrtare nuk kryhet për interesin publik të shërbimit, por për interesat private dhe personale të përfitimeve të ndryshme të paligjshme. Ky lloj kriminaliteti shënon një rritje në periudhën të hulumtuar kohore, ku më të pranishme janë veprat penale kundër detyrës zyrtare, me ç'rast kryerësit janë persona të arsimuar nga shtresat e larta shoqërore që kanë ndikim dhe autoritet shoqëror në sistemin ekonomik dhe juridik të shtetit tonë, me motivin kryesor të përfitimeve të paligjshme. Prandaj, një veçori qenësore e këtij lloji të kriminalitetit është fakti se kryerësit janë kryesisht nga pushteti qendror ose lokal, pra derisa janë në pozitë zyrtare, andaj, zbulimi dhe ndjekja penale e këtyre veprave penale rëndom ndodh pas ndryshimit të pushtetit qoftë në rrafshin qendror qoftë në rrafshin lokal. Në këtë punim shkencor, poashtu u konstatua se, një parakusht kryesor për luftimin dhe parandalimin e krimit kundër detyrës zyrtare është bashkëpunimi dhe koordinimi më efikas në trekëndëshin: policia, prokuroria publike dhe gjykata, me një theks të veçantë në zbatimin e masave të posaçme hetimore sipas normave ligjore procedural penale, ndërsa, nga ana tjetër, edhe aplikimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme jo vetëm nga personat fizik dhe juridik si kryes të këtij krimi, por edhe të pasurisë së personave të afërm me kryesin, nëse dëshmohet se bëhet fjalë për asete të fituara me aktivitete kriminale ose bartje të pronësisë me dokumente fiktive, meqenëse konfiskimi duhet tu tregojë kriminelëve se krimi megjithatë nuk paguhet. Në këtë drejtim, në këtë punim shkencor të magjistraturës, u verifikua edhe hipoteza gjenerale e këtij punimi për atë se, në RM, krimi kundër detyrës zyrtare paraqet veprën më të shpeshtë penale të krimit financiar, me ç'rast, ndriçimi dhe luftimi i tij, kërkon hetime eficiente penale, kriminalistike dhe financiare.

Detyra zyrtare është një pasqyrim real i shtetit. Në larminë e saj, ajo është një sistem në të cilin qëndron siguria e rendit ligjor, si dhe shoqëria si një tërësi, ku nëpërmjet shërbimit të duhur dhe të ligjshëm të saj, çdo shoqëri merr linjat thelbësore të portretit të duhur, e ku çdo shkelje e ligjshmërisë dhe keqpërdorimit të shërbimit, shpie në prishjen e këtij portreti shoqëror. Në këtë mënyrë janë manifestuar veprat penale kundër detyrës zyrtare të përshkruara në këtë punim.



Përmendet edhe korrupsioni si një dukuri që prish vlerat morale në shoqëri dhe ndaj të cilit asnjë shoqëri nuk ishte immune. Në të vërtetë, kjo është një sfidë për të gjithë zyrtarët dhe provë e përjetshme e tyre, në të cilën vendimi duhet bërë në lidhje mes kodit të etikës, ligjit dhe interesit personal. Andaj vlen të përmendet se të gjitha manifestimet e veprave penale kundër detyrës zyrtare janë të lidhura ngusht me korrupsionin. Në bazë të këtij punimi do të nxjerret në pah qasja teorike për veprat penale kundër detyrës zyrtare, dhe ndërgjegjësimin e arsytimit për rëndësinë e secilës vepër kundër detyrës zyrtare, praktika gjyqësore në lidhje me veprat penale kundër detyrës zyrtare. Numri i veprave penale kundër detyrës zyrtare bëhet nga ana e zyrtarëve dhe personave me pozita të larta në organet shtetërore.

Poashtu mund të konkludohet se korrupsioni është i pranishëm në të gjitha fushat e shoqërisë, si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat. Në mënyrë për tu luftuar korrupsioni në vend është e nevojshme që të krijohen masat e përshtatshme institucionale me aparat profesional dhe të depolitizuar shtetëror dhe zgjidhje më kualitative ligjore. Poashtu, zbatimi i duhur i ligjeve, sjellja e paanshme dhe profesionale e institucioneve dhe bashkëpunimi mes tyre, dhe gjithashtu vullneti i duhur dhe i sinqertë politik për anti-korrupsion ku sundimi i ligjit të mos mbetet vetëm në mënyrë deklarative por, realisht të zbatohet në praktikë.

## BIBLIOGRAFIA

### Libra, publikime, raporte dhe burime juridike

- Adnan Tulić, Krivična djela protiv službene dužnosti
- Aleks Nikolli, disa probleme teorike dhe praktike rreth veprave penale të falsifikimit të dokumentev dhe të mashtrimit, magjistrat, Universiteti i Shkodrës, viti 2014
- Babid Miloš, Markovidlvanka, Krivičnopravo, posebnidio, Banja Luka, 2007
- Bryan A. Garner, Black law dictionary, 9-th edition, WEST PUBLISHING CO, 2009
- Брошура – Потреба од следење на судски предмети од областа на корупцијата.
- Derenčinovic Davor, Dragičević-Prenjača Marta, Kaznenadjelaprotivslužbeneduznosti, Zagreb, 2009.
- Државен завод за статистика на Република Македонија, Годишни извештаи.
- Државен завод за статистика, Скопје, Статистички предлед на пријавени, обвинети и осудени сторители на кривични дела од 2009 до 2014 година.
- Витларов, Т, “Казнено – Правна заштита од корупција”, Скопје, 2005.
- George Moody Stuart, Korrupsioni i madh në zhvillimin e Botës së Tretë, 1997
- Grupa autora, Komentari krivičnih/kaznenih zakona u Bosni i Hercegovini, Knjiga I, Vijede Evrope i Europska Komisija, Sarajevo, 2005
- Fjorida Ballauri (Kallço), Konflikti i interesave në veprat penale të krzera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, Disertacion për mbrojtje e gradës shkencore “ DOKTOR”, Tiranë, 2015
- Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë 2011
- I. Salihu, E Drejta Penale, Prishtine, 2005
- J. Tahovikj, E Drejta Penale, Pjesa e veçantë, Beograd 1953
- J.Senturia, Enciklopedia e shkencave sociale, vol VI 1993
- Јовашевич, Д., Злоупотреба службеног положаја и корупција, Номос, Београд, 2005
- J. Проевски, “Кривичен законик”, објаснувања и коментари, Академик, Скопје, 1998
- Камбовски Владо, Казнено право- општ дел, Скопје, 2006
- Камбовски Владо, Казнено право- посебен дел, Скопје, 2011
- Камбовски Владо, Кривичен законик интегрален текст: предговор, кратки објаснувања и регистар на поими, Скопје, 2008
- Камбовски, В и Тупанчески, Н., Казнено право, посебен дел, 2011
- Камбовски, В., Организиран криминал, Скопје, 2005.
- Камбовски В. и Наумоски. П., Корупцијата-најголемо општествено зло и закана за правната држава, Скопје, 2002.
- Коалиција Сите за правично судење
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë
- Корупцијата во РМ од Михајло Маневски
- Kregar, Josip, Strategijaprotivkorupcije, Sarajevo, 2007.g.
- Ligji per parandalim te korrupsionit dhe konfliktit te interesave, Gazeta zyrtare e RM-se janar 2019, nr. 12

- Лидија Брашер Тајд (Lydia Brashear Tiede), Анализа на македонската казнена политика и препораки за нејзиниот иден развој: Кон поеднообразен систем, Декември 2012 година
- Metodija Angeleski, Regular Prof.; Dusko Stojanovski, Associate Prof.; Martina Nedelkovska, Student; Ivana Kurtevska, Student, Nikolina Gaberova, Student Dragan Milosovski, Student, European Scientific Journal February 2014 /SPECIAL/ edition vol.1 ISSN: 1857 – 7881 (Print) e - ISSN 1857- 7431, The financial crime in Republic of Macedonia Abstract, First private university FON – Skopje Macedonia
- Николоска, С., Кривични дела против службената должност-Скопје, 2008.
- Николоска, С., Феноменолошки карактеристики на криминалитетот против службената должност, Годишник на Полициска академија, Скопје, 2008.
- Правило за начинот на издавање и извршување на наредби во Армијата на Република Македонија, Бр.06-810/3 од 07.05.2012 година
- Програма за наблудување на судските предмети во врска со корупцијата во Република Македонија, Скопје, Декември 2008
- UNITED NATIONS OFFICE ON DRUGS AND CRIME Vienna; Business, corruption and crime in the Former Yugoslav Republic of Macedonia: The impact of bribery and other crime on private enterprise, 2013
- Shasivari, Jeton, E drejta administrative, Shkup, 2015
- T R Raghunandan, 08 Jan 2014 , Citizen Matters
- Закон за гранична контрола, Службен весник бр.148/15
- Zejneli, Ismail, E drejta penale-pjesa e posaçme, Tetovë, 2007.
- <http://www.legalmatch.com/law-library/article/falsifying-documents.html>
- <https://www.legalmatch.com/law-library/article/falsifying-documents.html>